



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 72/2016

Prishtinë, më 07.10.2016, në orën 19:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Glauk Konjufca, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë, si dhe Sabri Hamiti e Visar Ymeri, deputetë.

Munguan: Blerim Grainca, Sasha Milosavljeviq dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Agim Bahtiri, kryetar i Komunës së Mitrovicës, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës së Prishtinës; Petrit Gashi, Avni Jashari dhe Arben Limani – AKP dhe Sanije Berisha – OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-120 për Trepçën;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-120 për Trepçën

Kryetari i Komisionit, z. Muhamet Mustafa, propozoi që të analizohet nen për nen Projektligji, si dhe propozim- amendamentet nga grupet parlamentare dhe deputetët.

Glauk Konjufca propozoi amendament në nenin 1 si vijon:

Në nenin 1 të projektligjit, pas fjalisë “Ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore”, të shtohen fjalitë “për të transformuar njësitë e caktuara biznesore të ndërmarrjes ekzistuese Trepça, në ndërmarrje publike qendrore”, për të vazhduar si në përmbajtjen ekzistuese.

Pas debatit, Komisioni nuk e përkrahu propozim amendamentin e grupit parlamentar të LVV-së për nenin 1.

Rrustem Berisha tha se ne grupi parlamentar i AAK-së e kemi propozuar një amendament në nenin 1 si vijon:

“Me këtë ligj përcaktohet statusi juridik i Trepçës, që është shoqëria aksionare me përgjegjësi të pakufizuar e rëndësisë së posaçme dhe në pronësi publike, organizimi, organet, veprimtaria, mjetet e punës dhe të qarkullimit, asetet, fitimet dhe humbjet, ndarja e fitimeve, raportet juridike - biznesore me entitetet e pronësisë private e publike, aktet juridike të përgjithshme (statuti, rregulloret, rregullat), investimet dhe të drejtat themelore të punëmarrësve.”

Kryetari tha se pajtohet që nga ky propozim i AAK-së, të merret vetëm pjesa “pas fjalës “Trepçës” shtohet teksti “ si një ndërmarrje me rëndësi të veçantë”. Dhe ky të jetë Amendamenti 1 i Komisionit Funksional.

Pas debatit Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

Glauk Konjufca prezantoi propozim amendamentin e GP të LVV- së për paragrafin 1 të nenit 2 si vijon:

Paragrafi 1 i Nenit 2 të projektligjit ndryshohet si vijon:

1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë transformimin e njësive biznesore të listuara në paragrafin 2 të këtij neni në Ndërmarrjen Publike Trepça Sh. A.

Pas debatit, Komisioni nuk e përkrahu amendamentin e grupit parlamentar të LVV-së për paragrafin 1 të nenit 2.

Rrustem Berisha, propozoi që Nenit 2, paragrafi 2, t’i bashkëngjiten paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 11.

Pas debatit, Komisioni e përkrahu propozimin e z. Berisha, dhe ky amendament të vendoset te neni 11.

Kryetari, propozoi që te neni 3, pas nënparagrafit 1.1. të shtohet një nënparagraf i ri si vijon: “1.2. Trepça Sh. A. – shoqëri aksionare në pronësi 80% të Qeverisë dhe 20% të punëtorëve sipas nenit 4 të këtij ligji.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Glauk Konjufca prezantoi propozim amendamentin e GP të LVV- së që te nënparagrafi 1.1 i nenit 3 të projektligjit, pas fjalisë “me emërtimin “Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP” të shtohet fjalia “e transformuar me njësitë biznesore të parapara me këtë projektligj si ndërmarrje publike qendrore në pronësi të Republikës së Kosovës”.

Komisioni nuk e përkrahu amendamentin e grupit parlamentar të LVV-së për nënparagrafin 1.1 të nenit 3.

Raif Qela propozoi që te neni 3, pas nënparagrafit 1.5, të shtohet edhe një paragraf i ri si vijon: “Mbetjet teknologjike” mbetjet minerare dhe mbetjet industriale.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Enver Hoti propozoi amendament të GP NISMA, si vijon: nenit 4, paragrafit 4, t’i shtohet “se edhe punëtorët të cilët kanë punuar para vitit 1990 dhe kanë mbi 15 vjet përvojë punë, e të cilët janë gjallë, të behën pjesë e këtij paragrafi”.

Fatmir Rexhepi tha se unë po mendoj se punëtorët kudo në Kosovë janë njësoj, pavarësisht tash a punojnë në Trepçë a ka punuar në ndërmarrje tjera. Prandaj, mirëpo në qoftë se duhet që të bëjmë diçka të veçantë edhe ashtu i thonë “ligji i veçantë për Trepçën” atëherë unë jam dakord nëse ka edhe kjo atë anë e vetë që vetëm ato që po përmenden vetëm për njerëzit që kanë punuar në minierë.

Raif Qela propozoi që mënyra se si do të ndahet pjesëmarrjes e 20% të punëtorëve në aksione të mos trajtohet fare dhe ta ndryshojmë paragrafin 4 të nenit 4 si vijon: “Mënyra e ndarjes së aksioneve të punëtorëve sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni të caktohet me akt të veçantë nënligjor.”

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Besim Beqaj i prezantoi propozimet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike si vijon: “Të shtohet paragrafi 1.1 te neni 4, si vijon: Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk mund të këtë me pak se 50% të aksioneve në pronësi të saj dhe propozim amendamenti tjetër pas paragrafit 4, të nenit 4 të shtohet si vijon: “Pjesëmarrja në aksione e përcaktuar për punëtorët sipas nenit 4.2 të këtij ligji të shuhet me ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe në rast të vdekjes së punëtorit nuk mund të trashëgohen”.

Propozimi nuk u përkrah nga Komisioni.

Glauk Konjufca prezantoi propozim amendamentin e GP të LVV- së si vijon: Paragrafit 1 të nenit 5, t'i shtohet një pasues plotësues me këtë përmbajtje: Minierat, respektivisht resurset minerale nuk mund të jenë në asnjë mënyre objekt i aksionit të tjetërsuar.

Komisioni nuk e përkrahu amendamentin e grupit parlamentar të LVV-së për plotësimin e paragrafit 1 të nenit 5.

Raif Qela propozoi që te neni 5, pas paragrafit 4 të shtohet edhe një paragraf i ri 5 si vijon: “Trepça Sh. A. trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore.”

Pse duhet të shtohet ky paragraf është se projektligji lë jashtë mbetjet teknologjike, ku nënkupton që të lë gati një miliard euro pasuri të mbetjeve teknologjike.

Kryetari propozoi që propozimit të z. Qela t'i shtohet edhe teksti “dhe studimin e fizibilitetit”.

Pas debatit, Komisioni miratoi amendamentin si vijon:

Neni 5, pas paragrafit 4 shtohet edhe një paragraf i ri 5 si vijon:

“5.Trepça Sh. A. trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore dhe studimin e fizibilitetit.”

Visar Ymeri theksoi se te neni 6, paragrafi 1 thuhet se struktura organizative, kapitali themeltar, menaxhimi, çështja organizmit të Trepça SHA përcaktohet me statut të shoqërisë aksionare sipas legjislacionit relevant në fuqi, dhe kërkoi sqarime se për cilin legjislacion relevant bëhet fjalë.

Kryetari tha se i referohet legjislacionit relevant të Republikës së Kosovës, sipas këtij ligji dhe legjislacionit që është cituar në këtë ligj sepse në disa është cituar ndërmarrje publike.

Besim Beqaj tha se legjislacioni relevant është ligji për ndërmarrje publike dhe shoqëritë tregtare.

Visar Ymeri theksoi se siç po shpjegohet nuk është e qartë pasi që ky ligj lë dy alternativa të hapura, pastaj mund të zgjedhin se cilit ligj t'i referohen.

Kryetari propozoi që fjalia “legjislacionit relevant në fuqi” të zëvendësohet me “ligjit”.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Rrustem Berisha theksoi se te neni 6, pika 2 duhet të theksohet se Trepça është shoqëri aksionare publike me përgjegjësi me rëndësi të veçantë.

Kryetari sqaroi se këtë e kemi cekur më herët dhe e kemi përfshi te neni 1.

Sala Berisha-Shala tha neni 6, paragrafi 2 thotë se statuti i Trepçës hartohet nga bordi mbikëqyrës miratohet nga aksionaret. Unë mendoj se statuti i Trepçës hartohet nga bordi mbikëqyrës me pëlqimin e aksionareve me miratim nga Kuvendi.

Enver Hoti propozoi që paragrafi 2 (dytë) “statuti të jetë me pëlqimin e aksionareve dhe miratimin nga Kuvendi.”

Glauk Konjufca tha se nuk i pëlqen fjala pëlqim më mirë është miratimi dhe të gjithë pajtohen me fjalën miratim.

Pas debatit Komisioni miratoi amendamentin me tekstin si vijon:

Neni 6, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

2. Statuti i Trepça Sh.A. propozohet nga Bordi Mbikëqyrës, miratohet nga aksionarët, pas aprovimit të Kuvendit të Kosovës.

Rrustem Berisha propozoi që nenit 6, paragrafit 3 teksti “me këtë ligj dhe vlera e tyre përcaktohet në statut” të zëvendësohet me “me këtë ligj dhe vlera e tyre përcaktohet në procedurë ligjore.”

Kryetari theksoi se në statut kur të regjistrohet duhet me cekur vlerën, patjetër me procedurë ligjore, nuk mundesh me dalë jashtë ligjit. Propozoi që në nenin 6, pas paragrafit 4, të shtohet paragraf i ri 5 si vijon: “Pasuria e Trepçës dhe rezultatet e saj financiare paraqiten, në pasqyrat e konsoliduara financiare të Trepça Sh. A.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Kryetari pasi që nenit 7 mungon objekti dhe duhet të dihet se kush regjistrohet në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, kryetari propozoi që në nenin 7, pas fjalës “regjistrimin” të shtohet fjala “e Trepça Sh. A.”.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Sala Berisha-Shala e paraqiti propozim amendamentin e deputetit Shpetim Bulliqi që te neni 9, paragrafi 3, që fushave të ekspertizës t’i shtohet edhe fusha e “gjeoshkencave”.

Kryetari tha se jam kundër këtij propozimi sepse fushat e paraqitura të ekspertizës janë të mjaftueshme dhe s’ka nevojë t’i shtohet edhe kjo fushë.

Komisioni e përkrahu propozim amendamentin e deputetit Bulliqi, të prezantuar nga deputetja Sala Berisha-Shala.

Besim Beqaj, lidhur me nenin 9, paragrafin 9, tha që edhe në seancë duhet të qartësohet a kemi të bëjmë me funksionim të ndërmarrjes apo me transformim të ndërmarrjes, neni 9, pika 9, thotë “Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, me transformimin dhe shuarjen e njësive biznesore ...” , propozimi im është që të fshihet fjala transformim. Nëse e largojmë fjalën transformim, në nenin 12, unë propozoj se procesi i transformimit dhe strukturimit të ndërmarrjes Trepça SH. A të bëhet në harmoni me ligjin për ndërmarrje publike.

Glauk Konjufca prezantoi propozim amendamentin e GP të VV- së për paragrafin 9, të nenit 9 si vijon: 9. Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, transformimin e plotë apo të pjesshëm, dhe shuarjen e njësive biznesore ose investimet në projekte të reja, Bordi Mbikëqyrës,

respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës si aksionari kryesor, duhet ta marrë miratimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Me këtë shtesë qartësohet roli vendimmarrës i Kuvendit të Republikës karshi vendimeve për Trepçën.

Komisioni nuk e përkrahu propozim amendamentin e GP të LVV- së për paragrafin 9, të nenit 9.

Raif Qela lidhur me ligjin për ndërmarrje publike tha se është kjo që transformimi mund të bëhet përmes votës së Kuvendit.

Besim Beqaj ne kemi ndërmarrje, shoqëri aksionare që janë ndërmarrje publike në Kosovë, procesi i transformimit të ndërmarrja, nëse dëshirojmë të ia lëmë të gjithë fuqinë e vendimmarrjes Kuvendit sepse ligji për ndërmarrje publike e përcakton formën e shitjeve të aksioneve të ndërmarrjeve publike të cilat shndërrohen në shoqëri aksionare kështu funksion PTK, RTK, të gjitha.

Kryetari tha se për Trepçën e kemi ligjin e veçantë.

Visar Ymeri tha se dua ta shtoj këtë se transformimi dhe ristrukturimi përfshirë ndryshimin e strukturës aksionare duhet të jenë në përputhje me Kuvendin dhe me ligjin për ndërmarrje publike sepse janë të njëjta nuk kemi nevojë t'i përsërisim.

Enver Hoti tha se e kemi një propozim në nenin 9 nga profesor Hamiti është mirë ta trajtojmë që thotë se veprimet e parapara në paragrafin 9, të nenit 9, “të miratohen edhe në Kuvendin e Kosovës.”

Besim Beqaj tha se unë nuk pajtohem dhe propozoj që të hidhet në votim njëherë votimin e pikës 9, propozoj që ju ta hidhni në votim si të tillë kur vijmë te neni 12, e shqyrtojmë edhe një herë.

Kryetari kemi disa amendamente, e kemi amendamentin e profesor Hamitit, e kemi një amendament timin.

Sala Berisha- Shala tha se këtu ne e kemi eksploatimin dhe shfrytëzimin, qëllimi ka qenë me thënë hulumtimin dhe shfrytëzimin.

Kryetari theksoi se kjo ndërlidhet me investimet për hulumtimin dhe shfrytëzimin, mirë e aprovuam, a po pajtohem me hequr funksionimin, që është mirkromenaxhment. Pra, kush është për me hequr fjalën funksionim, në vend të fjalës transformim? Pra, unë pajtohem se transformimin nuk mundet me bërë bordin, pra transformim hiqet, pajtohem të gjithë.

Pas diskutimeve, Komisioni lidhur me paragrafin 9, të nenit 9 miratoi amendamentin si vijon: Neni 9, paragrafi 9 ndryshohet dhe shtohet një paragraf i ri 10, si vijon:

9. Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, funksionimin dhe shuarjen e njërive biznesore ose investimet në projekte të reja, Bordi Mbikëqyrës duhet të marrë pëlqimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës si aksionari kryesor.

10. Vendimet që ndërlidhen me investimet dhe partneritetet për hulumtim dhe shfrytëzim të mineraleve, si dhe transformimin e pronës të Trepçës Sh. A., Bordi Mbikëqyrës mund t'i marrë vetëm pasi të merret miratimi nga Kuvendi i Kosovës.

Besim Beqaj propozoi që në nenin 10, paragrafin 1 të fshihet fjalia “ndihmësit e tij” sepse është e panevojshme.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Beqaj.

Rrustem Berisha propozoi që te neni 10, paragrafi 1, në fund të paragrafit të shtohet teksti “si dhe kryetari i sindikatës së Trepçës”.

Kryetari sqaroi se bordin e përbëjnë menaxhmenti dhe nuk duhet të përfshihet sindikata, ndërsa punëtorët në cilësinë e aksionarëve përfaqësohen te vendimmarrja e aksionarëve.

Glauk Konjufca prezantoi propozim amendamentin e GP të LVV- së për nenin 12, paragrafin 1, si vijon: 1. Trepça Sh. A. në kuadër të procesit të transformimit dhe ristrukturimit me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e saj dhe rehabilitimin e saj do të përdorë modalitete të investimeve sikur të mëposhtmet, por pa u kufizuar vetëm në to: kreditë shtetërore; kreditë e kompanisë; emetimit dhe shitja e obligacioneve; partneriteti publiko-privat; investime direkte private; investime të përbashkëta; emetimi dhe shitja e aksioneve.

Pas diskutimeve Komisioni nuk e përkrahu propozim amendamentin e GP të LVV-së për paragrafin 1 të nenit 12.

Glauk Konjufca prezantoi propozim amendamentin e GP të LVV-së që paragrafët 3 dhe 4 të nenit 12 të fshihen.

Komisioni nuk e përkrahu propozim amendamentin e GP të LVV-së për fshirjen e paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 12.

Kryetari propozoi që nenit 14 t'i shtohet edhe një paragraf i ri me tekstin si vijon: “AKP duhet t'i ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për t'i realizuar të drejtat e Kosovës dhe të Trepçës lidhur me asetet e Trepçës në vendet e tjera.”

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Kryetari, te kapitulli i kreditorëve dhe të shohim njëherë se çka ka thënë AKP-ja:

Pas diskutimeve Komisioni e miratoi këtë amendament, si vijon:

Neni 15, ndryshohet si vijon:

1. Pretendimet kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2. Pretendimet tjera të mundshme kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të paraqitura deri në datën e vendosjes në likuidim të aseteve sipas nenit 14 të këtij ligji, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

3. Prej hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me Trepçën SH. A. do të trajtohen në përputhje me ligjin për Ndërmarrjet Publike.

Sabri Hamiti propozoi që afati për nxjerrjen e akteve nënligjore prej një vit të shkurtohet në gjashtë muaj.

Rrustem Berisha tha se edhe GP AAK e ka të njëjtin propozimin për zvogëlimin e afatit të nxjerrjes së akteve nënligjore.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Hamiti.

Pas diskutimit të projektligjit, Komisioni me 7 (shtatë) vota “për” dhe 1 (një) “abstenim”, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohen Raporti me amendamentet e Projektligjit nr. 05/L-120 për Trepçën.

2. Raporti t’iu procedohet Komisioneve të përhershme sipas procedurës.

Kjo pikë e rendit të ditës të transkriptohet.

3. Të ndryshme
Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 21:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa

KRYETARI MUHAMET MUSTAFA:

Atëherë kalojmë të nderuar kolegë mbledhjen e radhës së Komisionit.

Na është dashtë në fakt mu tubua grupi punues por po e shkurtojmë edhe ju lutem që .. Prandaj, po shkojmë drejtë në mbledhje të Komisionit për të shqyrtuar amendamentet e propozuara në bazë të debatit në Komision dhe në bazë të debatit sot në leximin e parë të Kuvendit.

Pra, rendi i ditës është: Shqyrtimi i Projektligjit L/120 për “Trepçën” me qëllim amendamentimi dhe dërgimi për lexim të dytë në Kuvend

Aprovohet rendi i ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Konstatoj se e aprovuam rendin e ditës dhe propozoj që të shkojmë nen për nen edhe të shohim cilat amendamente i kemi ose mundemi të shohim çështjet që i kemi pasur në raport të Komisionit. Si po propozoni a të shkojmë nen për nen, nenë për nen u morëm vesh, aprovohet propozimi, i kolegut Beqaj. Kalojmë nen për nen.

BESIM BEQAJ: Kryetar, i kemi disa propozime, amendamente që kanë prej anëve të ndryshme e pa u trajtua nuk bon mos t’i harrojmë.

KRYETARI: Jo, te neni i trajtojmë. Kush ka qua amendament edhe nuk ka pas raport të Komisionit tonë do tema të reja mos më hapni, të lutem.

BESIM BEQAJ: Shoqëritë civile një,

KRYETARI: Faleminderit, po kalojmë në trajtim nen për nen të ligjit.

Preambula, nuk ka pasur vërejtje, nuk ka pasur sugjerime. Këtu ka qenë dilema edhe thirrje për Ligji për ndërmarrje publike por janë thirr vetëm në Kushtetutë që është më e fortë për gjithçka edhe okej. Ka shkua kështu.

KAPITULLI I

Qëllimi, s’ka vërejtje.

GLAUK KONJUFCA: Këtu kur thotë për shembull “ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore tash e cila synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik” këtu vazhdon. Ne e kemi të formuluar për me thanë “për të transformuar njësitë e caktuara biznesore” mund ta dorëzojmë edhe me shkrim këtë, kështu që e keni më lehtë për me mujtë me përcjellë.

Të ndërmarrjes ekzistuese “Trepça”, në ndërmarrje publike qendrore. Për neve kjo është vitale, edhe nuk mendoj që është në kundërshtim me shoqërinë aksionare. Domethënë shoqëria aksionare mund të bashkë ekzistoj me... nuk e di pse për shembull frikësohen me quajt ...

KRYETARI: E dimë arsyetimin, e kemi dëgjua në diskutim, ne e kemi diskutua këtu por diskutimi edhe Komisionit atë ditë këtu edhe i debatit e kanë përkrahë këtë në tërësi. Kështu që, mendoj që nuk kemi të bëjmë me disa njësi kemi të bëjmë me një proces ...Trepçën, disa njësi

tërheqin .., disa tjera kanë mu transformua më vonë në...për arsye se ... pasigurime. Kështu që kisha thanë mos me i trajtua... Mendoj se nuk mund të kthehem në ndërmarrje publike, ky është mendimi im. Në qoftë se duhet të votojmë menjëherë atëherë shkojmë më tutje.

FATMIR REXHEPI:... Nuk ka më kthim mbrapa në modelin ekonomi të cilat nuk i qëndron prandaj, nuk duhet me humb kohë shumë, ...modelet të cilat ne duhet të mendojmë për të ardhmen e “Trepçës”.

KRYETARI: Faleminderit! Po mendoj që kemi diskuta shumë..

GLAUK KONJUFCA: Atëherë pse PTK-ja është kompani publike, a është mbrapa ekonomisë ekzistuese apo qysh është puna. Nuk qëndron argumentimi që kemi të bëjmë me një prapambeturi ekonomike nëse e definojmë diçka si publike.

KRYETARI: Dakord, ndërmarrje publike që u mbet pronësi të shtetit...

GLAUK KONJUFCA: Është argument që kjo komuniste,

FATMIR REXHEPI: Jo, jo s’është nuk është komuniste ..Veç ju kisha lutë mos me.... mendimin e dikujt pa e ...

KRYETARI: Fatmir, të lutem.

GLAUK KONJUFCA:Jo, jo është aluzion ky, është aluzion.

FATMIR REXHEPI:

KRYETARI: Ju lutem a po e pranoni që unë ... mbledhjen, a po pranoni

(Polemikë)

KRYETARI: Ne e dimë çka po bëhet me ndërmarrje...

GLAUK KONJUFCA: Jo këtu në botë, po gjithkund mujnë me ekzistua..

KRYETARI: Fatmirë, a më keni zgjedh mua kryetar me e kryesua këtë mbledhje ... sepse këto zgjatin shumë.

Visar, e ke fjalën të lutem.

VISAR YMERI: Faleminderit!

... shndërrimi i Trepçën në ndërmarrje publike nuk e përjashton astë trajtimit të saj në të ardhmen. Pra si Ndërmarrje Publike “Trepça” edhe mund të privatizohet pjesërisht edhe mund të privatizohet tërësisht sipas procedurës së vendimmarrjes që është përcaktuar me .. për ndërmarrjen publike.

Neve si Republikë e Kosovës asgjë s'duhet të na pengoj që ta transformojmë Trepçën në ndërmarrje publike dhe pastaj sipas politikave qeveritare të merret ... nëse Qeveria konsideron që sipas studimit të vizibilitetit ose bindjeve... që i ka ta privatizoj Trepçën mund ta bëjë atë. Nëse konsideron që do të mbajë në pronësi publike si do qoftë më mirë prapë mund ta bëjë atë. Dua ta them që kjo nuk është paragjykyese fare e së ardhmes së Trepçës, por është një siguri që sipas Ligjit për Ndërmarrje publike, vendimmarrje për Trepçën të jetë e shtrirë në aspektin politik e jo të jetë e kufizuar me një Qeveri.

KRYETARI: Urdhëro! Deputeti Beqa.

BESIM BEQAJ: Nuk ka shumë të keqe në të mu thirr edhe në ndërmarrje publike, por Ligji për ndërmarrjet publike e ka një aneks i cili përfshinë ndërmarrjet qendrore dhe nëse ne dom me e bë atë qysh po propozoni ju, ne se kishim bë Ligjin për "Trepçën" hiq veç e kishim shtua në aneks, në listë që "Trepça" të shndërrohet në ndërmarrje shoqërore e kishim përmbyll procesin. Kështu që ne jemi tu bë Ligj të veçantë për Trepçën i cili del mbi ata që kemi fol deri më tash.

VISAR YMERI: ..Çka... me ligj të veçantë

KRYETARI: Faleminderit, zoti Beqaj!

Vetëm një koment të shkurtë. Unë e kuptoj këtë por praktika po tregon që Ndërmarrje publike sidomos një shtet që është në ndërtim në forcim të institucioneve nuk funksionojnë mirë, edhe po shihet. Me këtë model ne e ruajmë interesin publik 80% edhe .. punëtorët që janë të interesuar ..

Domethënë e dyta e shkurtojmë qatë jo me privatizua por e shkurtojmë në mënyrë shumë më moderne të qeverisjes, këtu gjithmonë kur ta forcojmë rolin e Kuvendin më vonë. Kështu që mendoj që të ...një konsensus rreth kësaj, edhe ju kisha lutë që të ecim përpara sepse nuk ka konsensus për krijimin e ndërmarrjes publike. Urdhëro!

RRUSTEM BERISHA: Ne e kemi propozua një amendament që të formulohet neni 1 i këtij ligji edhe ne kemi qenë që të jetë shoqëri aksionare por të përcaktohen përgjegjësitë e pakufizuara dhe t'i jepet e rëndësisë së veçantë. Nëse mundet që kjo të shtohet edhe përgjegjësitë e pakufizuara.

KRYETARI: Rustem, rëndësi e veçantë mund ta shkruajmë përambulë mund ta shkruajmë ku doni, nuk kam asgjë kundër, por siç thonë shoqëria aksionare kjo është menjëherë ... se ... me kapitalin që është brenda jo me pasurinë tjetër. Kështu që nuk kemi nevojë me cekë përgjegjësi të kufizuar, si thuash shoqëri aksionare ajo e përfshinë e determinime është vetëm me përgjegjësi të kufizime nuk është me përgjegjësi të plotë.

GLAUK KONJUFCA: Por së paku me rëndësi të veçantë.

KRYETARI: Me rëndësi të veçantë, pajtohem.

KRYETARI: Cili nen, neni 1.

Neni 1, shtrohet fjala në vendin adekuat "rëndësi e veçantë" . Pajtohemi.

SALA BERISHA SHALA: Me qenë se jemi te neni 1, është një vërejtje e ime krejt teknike e natyrës teknike. Ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës, “Ky ligj ka për qëllim që përmes infrastrukturës ligjore” se ka për qëllim me krijua ligjin, e ka përveç ligjit ...

KRYETARI: .. Mund të thuhet edhe ashtu, po mund të thuhet edhe kështu mos të krijojmë problem me përkthime. Po dihet, unë jam që qëllim ...për rivitalizimin e Trepçës e cila është në rëndësi të posaçme. Ju lutem. Prej se i Trepçës si një kompani qysh me thanë që ka rëndësi të posaçme ..

RRUSTEM BERISHA: Edhe mendoj që është dashtë pak me kanë ky nen shumë më i zgjeruar jo vetëm pak fjalë, se këtu tregon shumë çka me përfshi, organet, veprimtarinë, mjetet e punës ...

KRYETARI: ...Si një kompani me rëndësi të posaçme shoqërore, nacionale a vendor, a qysh me e shkrua, cilën fjalë.

KRYETARI: Si një kompani me rëndësi të veçantë. Mirë u bë. Faleminderit!
Domethënë ne kemi amendament në nenin një, A doni me e qua amendamentin në Kuvend.

Atëherë votojmë kush është për amendamentin.
Po Trepça” ka qenë ndërmarrje po e ... sot Ndërmarrje me rëndësi të veçantë.

GLAUK KONJUFCA: Nuk di a ka te neni 1 najkush tjetër.

KRYETARI: Njëshi po e bëjmë një amendament me këtë, kjo e juaja ka propozime me bë ndërmarrje publike..

GLAUK KONJUFCA: Po veç e jona shkon kështu si propozim i joni,

KRYETARI: Po de si propozim i juaj, për atë po votojmë, a me bë a jo.

Ju lutem, e kemi amendamentin e Vetëvendosjes që “Trepça” të bëhet Ndërmarrje Publike, do me thënë ne e kemi dhënë arsyetimin këtu,interesi publik dhe interesi privat dhe nuk e konsiderojmë ... megjithatë ju lutem kush është për këtë propozim le ta ngritë dorën për Ndërmarrje Publike me bë. Një votë, atëherë amendamenti është pa përkrahje të Komisionit. Faleminderit!

Kalojmë te neni 2. Fushëveprimi.

A ka amendament për fushëveprimin.

GALUK KONJUFCA: Te dyshi po ashtu kam të njëjtën, a e din se tash për me ja përshtat që ky me qenë në përputhje me këtë, vetëm i shtohet këtu te dyshi “Shoqërisë aksionare që të jetë domethënë ndërmarrjes publike “Trepça” që është shoqëri aksionare. Tash kjo e njëjta si e para.

KRYETARI: Nuk është .. e ndërmarrje publike në qoftë se kem edhe punëtorët aksionarë, aty është puna. Përndryshe nuk kish pas kurrfarë problemi. ... me thanë me rëndësi të veçantë për atë është me rëndësi të veçantë. Me qenë se është me rëndësi të veçantë Qeveria i mbanë 80%

VISAR YMERI: Çka me rëndësi të veçantë, se me ligjet e Kosovës aktualisht ekzistojnë ndërmarrje shoqërore që janë me AKP, ndërmarrje publike ...lokale që janë të rregulluara me Ligjin për ndërmarrje publike dhe janë shoqëri tregtare e kjo tash çka është, ndërmarrje çka.....

KRYETARI: Ndërmarrje me rëndësi të veçantë ku kapitalin e ka Qeveria, Qeveria përkatësisht, institucionet e Kosovës, shoqëria e Kosovës 80%, 20% e kanë punëtorët. E kemi diskutua këtë në Komision.

VISAR YMERI: Ne e kemi infrastrukturën më të mirë

(Nuk transkriptohet)

VISAR YMERI: Çfarë kuptimi ...

KRYETARI: Ka qenë e nevojshme..

VISAR YMERI: Po disa ndërmarrje publike, ... Ligji për ndërmarrje publike.

KRYETARI: Vlenë..

VISAR YMERI: Atëherë, ke thanë kem edhe Ligjin për komunikacion.

KRYETARI: Vlen në masë të caktuar. Edhe ky ligj është mbi të gjitha ligjet tjera kur është puna për “Trepçën”. Urdhëroni!

RRUSTEM BERISHA: Te neni 2, e kemi një propozim që t’i bashkëngjiten paragrafi 1, 2 dhe 3 i nenit 11. domethënë te neni 2,

KRYETARI: Me qu nenin 11.

RRUSTEM BERISHA: Paragrafi 1, 2 dhe 3 pe i qitë te paragrafi 2 me ju bashkëngjitë edhe paragrafi 1, 2 dhe 3 i nenit 11. Po mendoj që kompletohet edhe ka, se kështu diqysh.

KRYETARI: Mos po na luajnë nenet edhe është problem mos po gabojmë...

RRUSTEM BERISHA: Nuk luajnë hiq, përkundrazi veç sa forcohet edhe hek, kem te neni 12, te paragrafi 2 t’i bashkëngjitet paragrafi 1. 2 dhe 3 e nenit 11.

KRYETARI: Okej. Pajtohemi, po ky kalon. Paragrafi 1, nenit 11, shënoni ju lutem.

Neni 3, Përkufizimet.

RAIF QELA: Më fal profesor, te neni 2, i shtohet ky neni 11,

KRYETARI: Jo, jo, nenit 11, ky paragrafi 2 shkon atje te neni 11 i cili flet....u rregullua atje. Mirë është.

(Konsultime)

Kush është për këtë amendament. Jo, jo ky po thotë me shkua neni 11, a the ashtu.

BESIM BEQAJ: Jo, jo, unë thash, neni 2 te paragrafi 2 t'i bashkëngjitet paragrafi 1,2 dhe 3 e nenit 11, veç këto tri paragrafe edhe nuk prishë asgjë punë.

KRYETARI: Po juristët na kanë bërë kështu me

KRYETARI: Nuk jam i sigurt tash, me qenë se përmbajtja mbetet e njëjtë... edhe nenin 2

Në rregull pajtohem. Kjo është renditje më e mirë , vazhdojmë. Faleminderit!

Kalojmë te neni 3, përkufizimet.

Dëgjoni ju lutem, përkufizimet e kemi “Trepçën” i kemi njësitë biznesore për Trepçën ishalla ka mujtë me pas përkufizim për “Trepçën”. Urdhëro!

BESIM BEQAJ: Ne me qenë se në Ligj flasim për katër forma të organizimit të mundshëm dhe pikën 1.7 e kemi, definitivisht ... publiko privat .. ndërsa forma tjera nuk janë të definuar ose duhet me e heq edhe këtë ose duhet me shti ...

KRYETARI: Atë me heq nuk mundemi por thirrëmi qysh janë të definuar në ligjet përkatëse. Vetëm më së pari që kemi “Trepça” që duhet me shkrua. Shkruani një amendament që e propozoj unë “Trepçën” SHA, masë Trepçës vjen “Trepça SHA”.

Trepça SHA, nënkupton shoqëri aksionare në pronësi të qeverisë 80% të gjithë asetëve të saj dhe me aksione të punëtorëve 20% të nivel të njësive biznesore, kjo është. Pajtohem.

BESIM BEQAJ: I aksionarëve me 80% në pronësi të qeverisë dhe 20% në pronësi të punëtorëve.

KRYETARI: Duhet me e lidhë me njësi atje se kemi atë problemin...

RRUSTEM BERISHA: Si met puna e përgjegjëseve.

KRYETARI: Janë shumë punëtorë diku, që...

(Nuk dëgjohet për traksriptim)

KRYETARI: E për atë duhet me..

BESIM BEQAJ: E për atë duhet me thanë çështjen e punëtorëve duhet me rregullua me akte ligjore.

RRUSTEM BERISHA: Prof, se kam të krjart prej këtyre tri përgjegjësive është dash me shënua aty, cila është, për shembull..

KRYETARI: Qe ku i kemi juristët. Kur themi shoqëri aksionare, a është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nuk është shoqëri me përgjegjësi ...

RRUSTEM BERISHA: Të kufizume, pa kufizume ose ...Kur ta shpjegosh për shembull çka është shoqëri me përgjegjësi të kufizume pa kufizume po duhet me ja caktua diqysh.

KRYETARI: Shoqëri aksionare është shoqëri aksionare.

BESIM BEQAJ: Mos u ngarko me të se nuk funksionon.

KRYETARI: Trepça SHA, formuloni atë qysh e thash unë definomi i Trepçës SHA. U bë.

GLAUK KONJUFCA: Te neni 3, te pika 1.1. domethënë përkufizimet me qenë si janë, këtu prapë duhet “ne insistojmë që pas asaj që thuhet “Trepça” është ndërmarrje nën administrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, domethënë të shtohet fjalia “Transformuar me njësitë biznesore të parapara me këtë projektligji si ndërmarrje publike qendrore në pronësi të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: S’ka në Kuvend pa përkrahje të Komisionit,..

GLAUK KONJUFCA: Po, po unë duhet me e lexua secilin amendament se është zyrtar ky.

KRYETARI: Po, pajtohem edhe deputetët le të votojnë. E hedh në votim propozimin...

GLAUK KONJUFCA: S’mujmë me anashkalua pa procedura këtu..

KRYETARI: Pa tjetër e respektojmë plotësisht, e respektojmë.
Kush është për amendamentin e deputetit Glauk Konjufca? Nuk është askush.
Amendamenti është pa përkrahje të Komisionit.

Kalojmë te neni 4..

RAIF QELA: Në përputhje me propozimin që e dhashë,

KRYETARI: Ku je tash?

RAIF QELA: Jam akoma te propozimet, me propozimin që duhet të futet edhe te resurset minerare, bartja e pasurisë të drejtave dhe ... njerëzore, në nenin 5 duhet me fut edhe çështja e mbetjeve teknologjike, si e tillë për shkak të kësaj duhet të jetë në përkufizime dhe mbi teknologjike...

KRYETARI: Kush?

RAIF QELA: Mbetjet ... mbetjet minerare bashkë me

KRYETARI: Hala se kemi trajtua atë, a po e aprovojmë a jo. Si ta aprovojmë e kthejmë këtu, mos e harro.

Mirë, tjetër nuk ka te përkufizimet. Ju faleminderit!

Deputeti Berisha, Urdhëro, te neni 4. Këqyrni a ka prua kush ndonjë amendament .

RRUSTEM BERISHA: Te neni 4, pika 4 propozojmë që kur të bëhet fjalë për asetet e punëtorëve të përfshihen punëtorët që kanë punua që nga viti 1989 e këndej.

KRYETARI: Mirë. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme që u diskutua edhe atje. Ne vetëm ta trajtojmë një herë këtë çështje mandej dalim te të tjerët.

Ju lutem, të dëgjohemi se do të jem të koncentruar dhe jem pak të lodhur.

Çështja e '89 ... e kemi theksua edhe më herët edhe në diskutimin e sot, është një çështje e ndihshme dhe është një çështje e rëndësishme. Prandaj, këtu mund të diskutojmë pak më gjatë edhe ta gjejmë subvencionin më të mirë. '89, edhe një herë kanë dalë në pension, dhe këtu aksionet janë marrë me një si me pritë qysh ka ndodhë gjithkund në botë. Ata janë dal në pension i kanë pensionet, kanë merita historike, shoqëria mund t'i valorizohen në forma tjera jo veç me ... këtu në "Trepçë".

E dyta, këtu e kemi kryetarin e komunës edhe kemi Raifin që e njehë "Trepçën" më shumë se na, sa jam informuar unë, secili prej tyre që ka shkua në pension e ka dikun të familjes aty të punësuar prej minatorëve, këtu kem të bëjmë veç me minatorë. Kështu që unë nuk kam kundër, por vetëm ta masim, e dyta duhet po ashtu ta kem parasysh.

Edhe një çështje tjetër që "Trepça" duhet me pas një kujdes ndaj minatorëve dhe njerëzve që kanë punua atje dhe "Trepça" i takon krejt qytetarëve të Kosovës, nuk i takon vetëm minatorëve. Po dua me thënë që s'mujmë tash me thanë... Raifi, Enveri e mandej shkojmë me radhë. Urdhëro!

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Kjo çështje do të mbetet problem edhe pavarësisht se qysh e zgjedhim ne do të ketë kritika për mënyrën se qysh do ta zgjedhim.

Unë propozoj që mënyrën se si do të ndahet 20% i punëtorëve të mos e s'trajtojmë fare dhe madje edhe ta heqim nenin 4 në të cilën thuhet se "jo më pak se tri vite nga hyrja në fuqi të këtij ligji për një arsye shumë të thjeshtë sepse ndoshta kjo është e bërë me nguti. Ka mundësi që kjo punë të rregullohet me një akt nënligjor më vonë edhe pas një analize më të hollësishme. Por kryesore të mbetet 20% e aksioneve për punëtorë.

KRYETARI: Këtë ne e kemi rregullua tjetër kund.

RAIF QELA: Unë propozoj që konkretisht që neni ...

KRYETARI: Pikën 4, ... në vend ... që mënyra e kushteve për kualifikim, kush është i kualifikuar me marr 20% me u rregullua me një akt të veçantë.

RAIF QELA: Që të mos kemi tash përplasje ...

KRYETARI: Ja Kuvendi, ja Qeveria nga Kuvendi është.

Edhe e dyta, 3 vjet po ... me heq, edhe nuk është mirë një që ka punua më pak se tri vjet me bë pronarë të aksionit edhe ajo ..

BESIM BEQAJ: Jo më pak se tri nuk diskutohet.

VISAR YMERI:.....

KRYETARI: Më shumë se tri ata janë, po është pyetja. Ky ligj thotë: Të gjithë ata që janë sot në marrëdhënie pune në këto miniera dhe flotacione të cilët kanë tri vjet përvojë pune në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ata që i kanë një vjet, dy vjet, dy vjet e nënë mujë nuk mujnë me që atë shërbim. Ky është propozimi i ligjit. E tash në qoftë se ndodhë krejt me i bë ...

RAIF QELA: Unë them që ky paragraf të hiqet krejt në mënyrë që t'i jepet mundësi që me aktin ligjor të rregullohet më vonë sepse mendoj që ka me pas...

KRYETARI: Urdhëro, se i kemi dy propozime, një propozim... Enveri tash e ka fjalën, ... vetëm po mundohem me i bë propozimet edhe me vendos më shpejtë.

ENVER HOTI: Lidhur me këtë nenin 4, paragrafi 4 po kemi një propozim përafërsisht po duket sikur i Aleancës, punëtorët që kanë punuar nga viti 1990 dhe që kanë mbi 15 vjet përvojë pune dhe të cilët janë gjallë bëhen pjesë e këtij ...

SALA BERISHA - SHALA: Që s'janë pjesë e minatorëve, që s'janë tu punu.

KRYETARI: Minierat dhe flotacionet janë qito tri njësi, po...

BESIM BEQAJ: Besoj që ne ligji nuk e përcakton mirë për këtë e ka fjalën,

KRYETARI: Po flasim për këto trija ato tjerat kur hynë atëherë bëhet diçka tjetër.

BESIM BEQAJ: Kështu ne duhet ta përcaktojmë sepse kemi pas probleme edhe me ligje me punëtorë, për shembull kur kemi fol për punëtorët e arsimit, ose për ata, ose për ata e dini ... ne duhet të definojmë a janë minatorë ata që përfitojnë aksione apo janë krejt punëtorët.

Nëse flasim për minatorët, flasim për njerëz të cilët kanë qenë nëpër tokë, nëse flasim për punëtorët atëherë nënkupton që flasim për secilin njeri që ka pas administratë çka di unë, ne duhet të definojmë këtë.

RRUTEM BERISHA: Shumë drejtë e ki.

BESIM BEQAJ: Unë besoj që edhe kështu është mirë, jo më pak se tri vjet nuk na ... veç ta përfundoj, jo më pak se tri vjet se kjo nënkupton edhe 15 dhe 20 edhe sa duash përmbas edhe kush ka qenë në punë edhe kush mund ta argumentojë që ka qenë në punë në rregull.

KRYETARI: Mirë, jo më pak se tri vjet qysh the ti edhe veç për minatorët.

ENVER HOTI: Minatorët, të cilët kanë punuar para vitit 19... dhe kanë mbi 15 vjet përvojë pune kanë pas 15 vjet përvojë pune dhe që janë gjallë bëhen pjesë e këtij paragrafi dhe kanë së paku 3 vjet punë...

KRYETARI: Që janë gjallë, por në qoftë se ...

Atëherë u diskutua që s'mund të jenë. Urdhëro, Visar.

VISAR YMERI: Po mendoj që këtu neni domethënë pika 4 edhe 3 janë shumë të qarta edhe qysh i kuptoj unë këto është kështu. Secili punëtor i njërive biznesore të shndërruara në Trepçë ... aktualisht janë tri miniera me flotacion e menjëherë... duhet me u bë sipas ligjit edhe dy metalurgji edhe industria kimike i aplikohet kjo e drejtë 20%.

Mirëpo ku është problemi, problemi që thuhet që mund të jetë pra nga radhët e punëtorëve në njësinë biznesore mund të jetë vetëm punëtori në marrëdhënie të rregullt pune që është në listën e pagave në njësinë përkatëse biznesore jo më pak se tri vjet ... që është në marrëdhënie pune dhe në listën e pagave. I ke njerëzit që kanë punuar 15 vjet por që nuk janë në marrëdhënie pune dhe në listën e pagave tre vjet para se me hy...

KRYETARI: Pse? Janë në pension.

VISAR YMERI: Është në pension, ka dal prej punës e ku ta di unë. Ai ka kontribut 15 vjet në Trepçë a e keni dikë me 3 vjet që e gëzon këtë të drejtë.

MUHAMET MUSTAFA: A ta bëjmë këtë vetëm për minatorë? Më e drejtë është, urdhëro.

FATMIR REXHEPI: Unë po mendoj se punëtorët kudo në Kosovë janë njësoj, pavarësisht tash a punojnë në Trepçë a ka punuar në ndërmarrje tjera. Prandaj, mirëpo në qoftë se duhet që të bëjmë diçka të veçantë edhe ashtu i thonë "ligji i veçantë për Trepçën" atëherë unë jam dakord nëse ka edhe kjo atë anën e vetë që vetëm ato që po përmenden vetëm për njerëzit që kanë punuar në minierë. Asnjë njeri që ka punuar në administratë ose në vendet tjera nuk mendoj që duhet me i dhënë benifite ... atyre duhet

KRYETARI: Lexoje edhe njëherë të lutem! Po!

ENVER HOTI: Unë për korrektësi se i keni materialet i kanë punëtorët por me siguri duhet ... me minatorët. Unë kam kështu,

KRYETARI: Më falni se unë s'po mund t'i lexoj krejt.

ENVER HOTI: Punëtorët të cilët kanë punuar atëherë i them punëtorët, por po e lexoj si minatorët: minatorët të cilët kanë punuar para vitit 1990 dhe kanë mbi 15 vite përvojë pune kjo mund të hiqet ose të mbetet kështu, e të cilët janë gjallë të bëhen pjesë e këtij paragrafi.

KRYETARI: Këtë po e bëjmë paragrafin 5 dhe po i shtojmë minatorët.

ENVER HOTI: Ju tash harmonizojeni dhe modifikojeni...

KRYETARI: Nuk mundemi t'i zgjedhim krejt problemet...

RAIF QELA: Unë po këmbëngul që krejt kjo është më mirë si paragraf...

KRYETARI: tjetrën anë po lypni Kuvend e tjetrën anë po lypni me i dhënë Qeverisë. Po tash po thotë edhe inxhinier, mirë edhe inxhinierët që kanë qenë ... pse jo.

BESIM BEQAJ: Por, edhe ata janë pjesë të asaj pune që është bërë atje. Tash nëse hyjmë me... unë mendoj që nuk kemi asnjë prej nesh këtu kompetencë të plotë me diskutuar lidhur me atë se kush sa kontribut ka dhënë atje edhe mund të gabojmë të gjithë ne.

Ndoshta është më mirë edhe pse është një diskresion shumë i madh që ndoshta do të duhej t'i jepet Qeverisë, por me thënë që kjo mund të rregullohet me akte nënligjore brenda periudhave të caktuara kohore, unë e di që është goxha e vështirë e dimë, mirëpo unë po jam komod po ju them personalisht komod që ne me vendos për kriteret ose atëherë s'po e heqim kriterin e minatorëve krejt po e lëmë krejt punëtorëve. Por me thënë tash po bëjmë fragmentim unë vetë e propozova për minatorët por kur po e analizoj ... të tilla është e vështirë.

Krijohen shumë probleme më të mëdha në terren, kemi me krijuar pakënaqësi të shumta, kemi me krijuar probleme shumë të mëdha prandaj.

KRYETARI: Mirë, është formuloje këtë të lutem. Po ua japim propozimin tënd. Mos të vendosim shpejtë se mundemi të gabojmë. Orientimi është që domethënë që at pjesën e juaj që me e përfshirë minatorët...

GLAUK KONJUFCA: Veç në anën tjetër edhe në pikën ... shpesh do çështje që janë thënë me akte nënligjore rregullohen, kurrë s'janë rregulluar. Shpesh po na ndodh është një taktikë për me i mshef problemet.

RAIF QELA: Paragrafi 4, i nenit 4 të fshihet dhe në vend të tij të bëhet ky formulim, përafërsisht më ndihmoni edhe ju: ndarja e aksioneve e 20% të aksioneve, nga radhët e punëtorëve në njësitë biznesore, mënyra e ndarjes së aksioneve duhet të përcaktohet me akt nënligjor të veçantë, veç duhet me tregu prej kujt...

GLAUK KONJUFCA: edhe jo më larg se...

KRYETARI: Po, po te bëjmë kështu. Unë po e formuloj tash mandej edhe njëherë e kqyrim masanej kur të vjen prej komisioneve tjera dhe mundemi me e ndreq prapë, s'është problem formulimin në qoftë se.

Domethënë, mënyra e ndarjes së aksioneve që ju takojnë punëtorëve sipas paragrafit 1, 2 dhe 3, duhet të përcaktohet me një akt nënligjor të aprovuar nga Qeveria jo më larg se gjashtë muaj ose tre muaj, ose gjashtë muaj, ju lutem aprovohet ky amendament. Ju faleminderit të gjithëve konstatoj që aprovohet amendamenti.

Ka propozime tjera, neni 4 jemi ende. Çka është e shoqërisë civile, kënd po e autorizojmë me e mbrojt shoqërinë civile me i lexu.

GLAUK KONJUFCA: Unë s'pritoj.

KRYETARI: Lexoi Besim, te neni 4.

BESIM BEQAJ: Te neni 4 kanë propozuar që të shtohet paragrafi 1.1 Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk mund të ketë më pak se 50% të aksioneve në pronësi të saj dhe propozimi dy pas nenit 4, thotë: "pjesëmarrja në aksionet e përcaktuara për punëtorët sipas nenit 4.2 të këtij ligji shuhet në ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe në rast të vdekjes së punëtorit nuk mundet të trashëgohet."

KRYETARI: A është kjo... a trashëgohen, nuk munden ... e dyta, është thënë edhe e para nuk po më duket, jo ju lutem.

Tjetër kush në qoftë se ka diçka.

BESIM BEQAJ: Në bazë të kësaj nëse dikush është përfitues i aksionit ai është përfitues i aksionit e cila duhet të regjistrohet diku si aksionar. Edhe tash nëse shuhet me marrëdhënie të punës, që unë s'kam dëgju kund që shuhet aksionet kur shuhet marrëdhënia e punës. Mundet me i shit, mundet me ia fal dikujt është pronë e tij.

Prandaj, s'po di.

KRYETARI: Jo, jo as nuk po e marrim në diskutim atë, tjetër a ka diçka.

Nenin 4 a ka diçka? Nuk ka! Kalojmë në nenin 5.

Raif mos na kthe prapa të lutem. A jemi në 4 a ku jemi, po dola në 5. Neni 5, ju lutem amendamentet kush i ka prej komisionit edhe amendamentet tjera që janë prezantuar urdhëro, Glauku i ka.

GLAUK KONJUFCA: Se qitu tash te neni 5, tash këtu në pikën e parë që po i thoni paragraf ju "resurset minerale janë pronë e Republikës së Kosovës" mirë shumë. Kjo domethënë po e definon pronësinë, mirëpo kjo më poshtë kur po vazhdojmë kurrkund nuk po ia jep një imunitet prej tjetërsimit të kësaj prone dhe nuk po thuhet kurrgjë.

Prona ka plotë, por nganjëherë, jo qitu me e shtu një 2-shin domethënë 1-shi është qikjo janë pronë e dyshi me qenë “minierat, respektivisht resurset minerale nuk mund të jenë në asnjë mënyrë objekt i aksionit të tjetërsuar”.

KRYETARI: S’po e kuptoj këtë. Kur thuhet pronë e Kosovës domethënë s’mund të tjetërsohet.

GLAUK KONJUFCA: Jo, jo pse ajo thuhet që është pronë e Kosovës por po e shitni çka ka lidhje.

KRYETARI: Veç me rend të lutem, sonte s’kemi ardhur këtu mu kqyr po me bë zgjidhje.

GLAUK KONJUFCA: Kjo domethënë unë e kam për mineralet.

KRYETARI: Për minerale na pajtohem të gjithë plotësisht, aty s’ka.

GLAUK KONJUFCA: Po, veç domethënë jo veç pronësinë po që edhe ato nuk janë kurrsesi mënyrë të tjetërsuara. Një dysh me ia shtu.

KRYETARI: ... shkruajmë në vazhdim “dhe nuk mund të tjetërsohen”. Po, po s’ka kurrfarë problemi. Nuk mund të tjetërsohen. Shkruajeni, vazhdojeni qaty.

Kush për këtë amendament?

GLAUK KONJUFCA: pse ti a je mu tjetërsua minierat dhe mineralet...

KRYETARI: Në qoftë se e forcojmë me këtë punë...

GLAUK KONJUFCA: ...tjetërson ato, prej Republikës së Kosovës ua jep njëfarë Majkëll Gjjonsonit. Ajo s’ia jep imunitetin asaj veç pse është pronë e Kosovës, duhet me thënë...

KRYETARI: Në rregull është logjike kjo.

GLAUK KONJUFCA: Në shfrytëzim thotë dyshi, që janë.

KRYETARI: Po, dyshi thotë që jepen në shfrytëzim. Unë e kam kuptuar që qashtu është në qoftë se ti mendon se kjo e ndreq më mirë ok.

Ju lutem, Visar. Mos shto ma kjo nuk mund të tjetërsohet. S’ka shpjegim mos e bë shpjegim se u pajtuam me bo vaki me thënë nuk pajtohem kur te shpjegon ti. Me këtë shtesë zgjidhet problemi, në qoftë se ke menduar diçka tjetër atëherë mundet me na dal problemi. Urdhëro!

VISAR YMERI: Mendoj që kjo aksioni të tjetërsuar me gjasë ... siç e përcjella unë diskutimin. ...

KRYETARI: S’ka aksione, çfarë aksionesh... nuk mund të tjetërsohen. Ok, lexo!

VISAR YMERI: Minierat, përkatësisht resurset minerale nuk mund të jenë asnjë objekt i aksioneve ...

KRYETARI: Ju lutem, a po e pranoni këtë ndryshim a po e votojmë amendamentin qysh e keni thënë. Jo, jo unë.. e aksioni këto sende atëherë duhet na t'i shpjegojmë njëqind sende këtu ...

VISAR YMERI: Nga shoqëria aksionare kemi aksione të cilat janë të tjetërsueshme.

KRYETARI: E s'mundet kjo të tjetërsohet mineralet s'ka aksione në minerale, unë s'di ku po i gjeni ato aksione minerale ju. Po s'ke çka me lexu se s'ka aksione...

S'po di ku po i gjeni këto.

VISAR YMERI: Minierat ose resurset minerale po thuhet këtu në amendament ...

KRYETARI: Janë pronë e Kosovës...

VISAR YMERI: Jo, jo amendamentin që e kemi propozuar ne minierat, respektivisht mineralet.

KRYETARI: E minierat është tjetër.

VISAR YMERI: Këto janë përfundojnë në shoqëri aksionare.

KRYETARI: Nuk pajtohem në këtë aspekt. Unë thashë edhe nuk mund të tjetërsohen mund të shtojmë në vazhdim të kësaj, qikjo çka mundemi. Në qoftë s'e tërhiqni e votojmë amendamentin e juaj kush do të votojë, kush s'do ok.

Apo e bëni komplet amendamentin apo po pajtoheni me këtë?

GLAUK KONJUFCA: Jo, jo kjo është mirë me na qëndru i plotë se ashtu...

KRYETARI: I plotë, kush është për amendamentin e "Vetëvendosjes" ju lutem? Një votë, nuk kalon pa përkrahje të komisionit.

Shkojmë më tutje, tjetër tash kolegu Qela e ka fjalën.

RAIF QELA: Neni 5, resurset minerale. Bartja e pronësisë, të drejtave dhe burimet njerëzore i shtohet edhe një paragraf si në vijim: paragrafi 5.5 ... a trashëgon të drejtën në valorizimin e mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore. Pse ky propozim? ... jashtë këtij ligji e mbetjeve teknologjike nënkupton që t'i lëmë diku gati 1 miliardë euro pasuri... po, po ju thoni jo, po po qe pse.

KRYETARI: A mi dhe sasi të, thashë me i pru sasi të e çmimit jo me fol përmendsh.

RAIF QELA: Po, 68 milionë ton mbetje minerale janë qato, me çmimin e përafërt të tregut të shitjeve të fundit mund të nxjerrim shifra të përafërt prej 884 milionë euro të pasurisë ...

KRYETARI: ... në qoftë se ti e ke teknologjinë me i nxjerr ato, por sa duhet me i investu me i bë këto. u bo, unë pajtohem me ty veç mos nxjerrim vlerësime se ato studime, mos e zgjat se po të përkrahim. Qata po dua ta them se s'kemi kohë.

GLAUK KONJUFCA: Po qa se caktojshi në 8 të sabahut, por në 3 e po na ngutni.

KRYETARI: Mos folni ju lutem, vazhdo vazhdo.

RAIF QELA: Paragrafi 5.5 “Trepça” SH.A. trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore.

Në përputhje me të edhe duhet të shtohet si term edhe ...

KRYETARI: Ama tekstin këtu, mirë Besimi ndoshta një propozim ... vetëm e kemi një problem a janë asete shtetërore a të kujt janë.

RAIF QELA: Këto janë mbetje të Trepçës, të minierave të ndryshme, të cilat do të ishte dashur të ndahen në përputhje me sasinë që është sjell e mbetjeve nga minierat të caktuara.

Nëse ka pretendime që këto në përputhje me nenin...

GLAUK KONJUFCA: Raif, ti është dashur me i pas këto përpara duarve.

RAIF QELA: Po po por sot...Po, në përputhje me nenin 6, paragrafi 3 ku thuhet se asetet e njësive biznesore të përcaktuara me këtë ligj dhe vlera e tyre përcaktohet me statut, në përputhje me këtë. Ndarja e tyre eventualisht nëse duhet sipas njësive biznesore në përputhje me atë sa kanë qenë mbetjet për shembull të Trepçës sa kanë qenë mbetjet të një miniere tjetër, të Artanës e tjera.

KRYETARI: ok, ne po e lëmë “Trepça” SHA, këto le t'i trajtojë pajtohemi, urdhëro Besim a pate ndonjë formulim.

BESIM BEQAJ: Jo, unë mendoj që formulimi është i mirë, ne flasim për mbetjet të cilat nuk janë vetëm të Trepçës, por janë edhe mbetjet të tjera të cilat edhe janë shit diku me autorizime, diku pa autorizime. Besoj që është shumë mirë që ato me mbet në pronësi të “Trepçës SHA” dhe realisht me u valorizuar përmes saj.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! A ka ndonjë koment për mbetjet? Për tjerat kur të vijmë aty. Po, për qito po ju pyes direkt se ju e keni administruar Trepçën a keni ndonjë vërejtje në këtë amendament.

ARBEN LIMANI - AKP: Është një nen në këtë ligj që thotë që edhe njësitë e reja munden të themelohen në të ardhmen varësisht se çka thotë studimi i fizibilitetit, nuk jemi shumë të sigurt nëse vlera e mbetjeve është proporcionale me vlerën e efektit... që ndoshta në të ardhmen është më mirë ju një njësi të re me e krijua në bazë të fizibilitetit që bëhet se sa ...

KRYETARI: Faleminderit! Unë propozoj që të aprovohet kjo që ka propozuar kolegu Qela. “Trepça” SHA trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin të tyre në përputhje me standardet mjedisore dhe studimin e fizibilitetit. Pajtohemi të gjithë, kush është për? Faleminderit!

FATMIR REXHEPI: Ne rregull është..

KRYETARI: Mirë, a ka dikush nenin 5 diçka? Nuk ka! neni 6, a ka dikush amendament, a ka qu dikush selam kështu anash kallëzoni. Zotri urdhëroni!

RRUSTEM BERISHA: Ne e kemi te neni 6, pika 2 e ligjit duhet t’i shtohet qajo që është shtuar në fillim “rëndësi të veçantë” edhe te neni 6, paragrafi 3. Po, pasi është atje veç e vazhdon.

KRYETARI: Po, ajo nënkuptohet se është definicioni ashtu.

RRUSTEM BERISHA: Atëherë, shkojmë te neni 6, paragrafi 3.

KRYETARI: Unë këtu kam një amendament ju lutem, po urdhëro ti ku e lash at tekstin që e keni shpërndarë.

RRUSTEM BERISHA:...Ne Statut...

KRYETARI: Aty në statut ku regjistrohet duhet me qenë patjetër vlera e tyre. Mirë, po në statut duhet me shkru vlera... ju lutem unë kam këtu një, pika 4 e këtij edhe shkojmë: pasuria e “Trepçës” SHA dhe rezultatet e saja financiare pasqyrohen në pasqyrat e konsoliduar financiare të “Trepça” SHA.

Kjo mungon, ne kemi thënë që janë llogaritë pasqyrat evidentuese të njësisë, por “Trepça” i ka për krejt “Trepçën” e konsoliduar. Edhe pasurinë edhe pasqyrat, kjo është me rëndësi me e ditë. Vetëm Visari e ka paraqit që 2-3 herë, urdhëro Visar.

VISAR YMERI: Këtu te neni 6 paragrafi 1, po thuhet që strukturat e angazhimit menaxhimin e çështjeve ... të “Trepçës” SHA përcaktohen me statut në shoqëritë aksionare sipas legjislacionit ... në fuqi, duhet të definohet me cilën...

KRYETARI: Me legjislacionin relevant në Republikën e Kosovës.

VISAR YMERI: Cili ligj është relevant për këtë çështje specifike? Pastaj, kemi te pika 2, ...

KRYETARI: Sipas këtij ligji dhe legjislacionit që është cituar në këtë ligj, se në disa raste është cituar “ndërmarrje publike”... edhe është cek atje.

VISAR YMERI: Qito duhet të përcaktohen në cilin ligj bazohen.

KRYETARI: Sipas këtij ligji dhe ligjeve...

RAIF QELA: Mendoj qe legjislacioni relevant është Ligji për ndërmarrjet publike...

BESIM BEQAJ: Përkufizimi thotë: “legjislacioni relevant e përfshin edhe Ligjin për ndërmarrjet publike edhe Ligjin mbi shoqëritë, e tash relevant në rastin tonë, Ligji mbi shoqërinë aksionare dhe Ligji për ndërmarrjet publike është struktura e saj ka me u ndërtuar mbi bazën e qysh e ka përcaktuar Ligji për ndërmarrjet publike, ndërsa menaxhimi që ka me u bërë në të ardhmen mbi bazën e udhëheqjes korporative, së paku unë kështu e kam kuptuar, bëhet mbi Ligjin për shoqëritë.. Për këtë arsye janë dy ligje, meqenëse e mora fjalën tek pasuria veç ta përfundoj këtë veç një minutë, propozimi që thatë pasuria e Trepçës jo pasuria “Trepçës” SHA po pasuria e “Trepçës” dhe rezultatet e saja pasqyrohen në pasqyrat e konsoliduara financiare të “Trepçës” SHA, sepse e kemi një ndërmarrje e cila duhet ... do të thotë me prej të parës sepse nuk mundet SHA-ja me i transferu në SHA.

KRYETARI: Mirë, pasuria e Trepçës, po flasim për “Trepçën” SHA këtu. Jo, s’kemi çka me transferua por me prezantu në bilanc edhe me i konsoliduar, me i valorizuar pasurinë atyre ... kompanisë, që ka ra kërkesë që s’është bërë dhe s’është me rëndësi.

BESIM BEQAJ:...ski çka me transferu...

KRYETARI: Urdhëro, Enver se ti e njeh kontabilitetin.

VISAR YMERI: Veç te përfundoj qita, qysh po e shpjegon deputeti Beqaj nuk është e qartë në ligj edhe me këtë formulim të këtij neni, të këtij paragrafi kushdo që thirret në këtë ligj mundet me e zgjedh cilën ditë po donë me apliku për strukturën organizative.

E Ligji për ndërmarrjet publike dhe Ligji për shoqëritë tregtare nuk është i njëjtë për sa i përket kësaj çështje. pra, janë të kundërt.

KRYETARI: Sipas këtij ligji edhe u kry muhabeti, se në këtë ligj thirremi ku duhet shoqëritë tregtare dhe ku duhet në shoqëri publike. Edhe s’kemi legjislacion relevant.

Sipas ligjit u bërë. Urdhëro, të lutem!

SALA BERISHA SHALA: Kryetar, neni 6, paragrafi 2 statuti i Trepçës, thotë: “hartohet nga bordi mbikëqyrës miratohet nga aksionarët”. Po mendoj “statuti i Trepçës hartohet nga bordi mbikëqyrës me pëlqimin e aksionarëve në miratim nga Kuvendi”.

KRYETARI: Ok, tre po bëjmë qitu Kuvendi po e shkruajmë te statuti është me rëndësi. Pajtohem me miratu Kuvendi statutin e Trepçës...

GLAUK KONJUFCA: Qysh the, me 2/3 a?

KRYETARI: Mua po më vjen keq por nuk mundem me ju dhënë atyre që s’janë deputetë fjalën, vetëm kur t’i thërras.

Po, urdhëro në qoftë se në cilën pikë je? Urdhëro Agim, kryetari i komunës vetëm se e kemi për shkak të kohës jo diçka.

AGIM BAHTIRI – KRYETAR I KOMUNËS SË MITROVICËS: ... kompania aksionare domethënë bordi themelohet prej dy aksionarëve. Ai vendos domethënë.

KRYETARI: Por, meqenëse thamë ndërmarrje me rëndësi të veçantë. Mirë mirë po këtu institucionet e Kosovës janë 80%, Kuvendi mund ... anëtarëve të Qeverisë... prandaj s'ka kontradiktë këtu, ne mundemi ...

Urdhëro!

ENVER HOTI: ... propozimin që e kemi bërë i njëjti është si i deputetit veç ... statuti me pëlqimin e aksionarëve dhe me miratimin Kuvendit.

KRYETARI: Hartohet nga bordi mbikëqyrës, miratohet nga aksionarët me pëlqimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ok!

SALA BERISHA SHALA: Kryetar, Kuvendi nuk bën pëlqime Kuvendi miraton me pëlqimin e aksionarëve dhe miratimin e Kuvendit.

KRYETARI: Jo, të lutem statuti miratohet nga aksionarët, këta ... që i kanë 80% munden me e votuar atë në qoftë se kanë marrë lejen e Kuvendit, prandaj të jemi konsekuentë, me pëlqimin e Kuvendit.

GLAUK KONJUFCA: S'po më pëlqen qikjo fjala "pëlqim për Kuvendin". Po, por "pëlqim"...

KRYETARI: Ok, e ndërrojmë "me miratimin", ok. Ky është vendim për ata që .. po, vendim.. ky është vendim për ata që kanë me u zgjedhë në bord atje. Nuk munden me e aprovua statutin, në qoftë se s'e kanë marrë vendimin e Kuvendit, që edhe Kuvendi ta ...

KRYETARI: Me miratim është vendim...

GLAUK KONJUFCA: Jo, miratim tha...

KRYETARI: OK. E kryem edhe një. Edhe rolin e Kuvendit këtu e kemi zgjedhur, definitivisht e kemi zgjedhur. Vetëm pak, mirë, mirë, e shohim atë. Asetet te "Trepça" ... u kry kjo.

Katërshi, qatë tënden e aprovuam, këtë: "Pasuria e "Trepçës" dhe rezultatet e saj financiare pasqyrohen në pasqyrat e konsoliduara financiare të "Trepça" SHA. OK.

BESIM BEQAJ: Është si kapital themeltar, që është kah shkon...

KRYETARI: Po, po, edhe e kemi të forcuar në nivel të "Trepça" SHA, jo të njëjësive, tash se e krijojmë unitetin e "Trepçës".

RAIF QELA : Profesor!

MUHAMET MUSTAFA: OK. A pajtohet qikjo? Veç mos u ngutni!

RAIF QELA : Po, veq të “paraqitet” është më mirë me thënë, se sa “pasqyrohet në pasqyra”.

KRYETARI:: Ah, bravo, bravo, bravo, qashtu! Aprovohet! “paraqitet në pasqyrat e konsoliduara financiare të “Trepça”... Mirë, u kry kjo!

Hajde të shkojmë, neni 7, ju lutem. Këtu ishalla s’ka kurrkush! S’ka? Faleminderit!

Neni 8, a po? Urdhëroni, zotëri!

RAIF QELA : Të nderuar deputetë,
Mendoj se neni 8, 9 dhe 10, shumë lehtë do të kishte mundur të formuloheshin me një paragraf ose dy paragrafë të vetëm.

KRYETARI:: Jo...

RAIF QELA : Pse?

MUHAMET MUSTAFA: Pse, po të kallxoj.

RAIF QELA : ... sepse, mirëpo unë po e jap mendimin. Krejt këto janë çështje të Statutit, i cili mund të rregullohet prej Bordit Mbikëqyrës, është bord i aksionarëve, është...

KRYETARI:: Po di ku po del, po dua të të them që ne duhet me i caktua disa përgjegjësi disa... rreth bordit, se është shumë ndërmarrje e rëndësishme edhe jemi thirrë aty ku duhet, kështu që unë e di që ka edhe asi idesh, por ne duhet me i qit do gurë të fortë këtu, që mos me mujt me prish. A u kuptuam apo jo?

RAIF QELA: Në rregull, unë po tërhiqem.

KRYETARI:: Të lutem, po, po. Mirë bëre. Urdhëro për... këto t’i kqyrim qet nenin 8 mandej 9. A jemi me 8-shin në pajtim? Po.

9-shi,

ARMEND ADEMAJ: Kryetar, a bën një sekondë? Te shtatshi edhe një herë me u kthy?

KRYETARI: Për çka?

ARMEND ADEMAJ: se ky kolegu...

KRYETARI:: Kush jeni ju?

VALON DOBRUNA : Kolegë i Kuvendit.

KRYETARI:: Zyrtar? Po, urdhëro.

VALON DOBRUNA : Qiky paragrafi, ... dua me thënë është pa subjekt, realisht. Edhe aty duhet me u shkrua një tekst, te “SHA “Trepça”. Domethënë, duhet kështu, më lejoni ta lexoj.

KRYETARI : Ministria në emër të Qeverisë e regjistron...: Ani, shkruni, mirë... ku? Neni 7 a? Edhe atje tani “SHA “Trepça” i qesim definimet në fund i japim te...

Sipas nenit 7 e themi: “Trepça SHA” domethënë Organizata në pajtim me nenin 7.”

BESIM BEQAJ: A bën veç ta formulojmë, se ... s’... Do të thotë Ministria në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës do të merr të gjitha veprimet juridike për regjistrimin e “Trepça” SHA në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit”.

KRYETARI:: Mirë!

BESIM BEQAJ: Ecim, shkojmë në 9-she, unë te 9-shi kam.

KRYETARI:: Organizimi dhe regjistrimi këtu është a? Pse me e shkruat këtë?

BESIM BEQAJ: Jo, bre duhet...

GLAUK KONJUFCA: Po thanë duhet me ia shkrua emrin.

KRYETARI:: Paj, krejt qashtu është. po, qe ku i ki kapitulli 2. Po ani, po ni nen i ka disa tituj. Po, një nen mundesh me disa tituj.

KRYETARI:: Po, qe ku e kemi regjistrimin, ju lutem, veç mos na nxirrni punë, ju lutem mos na nxirrni probleme. Hajde, shkojmë më tutje. Ju e dini teknikën aty, shkruajeni, në fund mos na shtini të diskutojmë për sende teknike. Në fund, veq i shkruani dhe ne ua aprovojmë, veq me përmbajtje mos luani. Hajde. Neni 9.

GLAUK KONJUFCA: Qe unë e kam...

KRYETARI:: Beqaj edhe Glauku.

BESIM BEQAJ: Kryetar,

Unë e thash edhe në seancë, neni 9 duhet me u qartësua, a kemi të bëjmë me funksionim të ndërmarrjes apo kemi me transformim të ndërmarrjes. Nëse ka ... është 9-shi.

KRYETARI:: Cila pikë? Ah, pika 9 e 9-shit!

BESIM BEQAJ: Thotë: “Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin... Ligji pastaj thotë: “transformimin dhe shuarjen e njësive...” Ne, unë, propozimi im është ky: të fshihet fjala “transformim”...

KRYETARI: Po...

BESIM BEQAJ: ... dhe të shkojmë me “funksionim”, sepse nëse flasim për “themelim”, “funksionim” dhe “shuarje të njësive”, Bordi Mbikëqyrës duhet të marrë lejen e Qeverisë, apo miratimin paraprak të Qeverisë, por jo me Vendim të Qeverisë me bë transformim.

KRYETARI: Transformimi me qenë me vendim të Kuvendit?!

BESIM BEQAJ: Po. Me e heq fjalën “transformim” me e bë “funksionim”, ndërsa në nenin 12 pastaj, nëse më lejoni, meqenëse lidhet me këtë ...

KRYETARI: Ngadalë, mbaje në mend atë...

GLAUK KONJUFCA: Jo, s’mundemi ashtu. Jo, s’bon.

KRYETARI: Veç, ti po don atje “transformimin” me e bo...Hajde veç mos të dalim...

BESIM BEQAJ: Dëgjo, është e ndërlidhur me këtë... edhe ju kisha lutur,

KRYETARI: Hajde, vazhdoni.

BESIM BEQAJ: Nëse e heqim fjalën “transformim”, atëherë unë propozoj që procesi i transformimit dhe ristrukturimit të Ndërmarrjes “Trepça” SHA të bëhet në harmoni me Ligjin për ndërmarrjet publike. Kështu që, do të duheshe edhe me shtua paragraf të ri pas...

KRYETARI: në këtë kapitull jo, këtu mund të shtojmë, këtu mundemi me shtua çka të duash. Këtu.

BESIM BEQAJ: Pse? Më mirë është kështu qysh po them unë, se këtu është përzierje, këtu kemi “themelim” dhe “shuarje”. Janë aktivitete menaxheriale brenda një ndërmarrjeje. “Transformimi” s’është aktivitete që lidhet vetëm me aktivitetet e menaxheriale.

KRYETARI: Këtu është involvimi i sektorit privat, nuk do të thotë që është transformim, po këtu po i themi “Bordi”, çka mund të bëjë. Unë pajtohem që, për shembull, te... vetëm ta shohim... për shembull,

BESIM BEQAJ: Po, Bordi s’mund të bëjë transformim.

KRYETARI: Po, s’mund de! Pajtohem, pajtohem aty, po këtu po e lëmë. Eh, mirëpo, vetëm një çështje ta diskutojmë. Ne duhet të jemi të kujdesshëm. Unë pajtohem, që Kuvendi gjithkund... qe tash a po sheh që më the... domethënë, ndale ti tash po e lëshoj unë...

Duhet të ruhem që Kuvendi të futet në mikro-menaxhment, siç ka tendenca. Futja e Kuvendit në mikro-menaxhment të bizneseve është e rrezikshme edhe janë probleme këto. Transformimet nuk janë mikromenaxhment por, domethënë mund ti bëjmë transformimet 1 edhe 2, kur është fjala për partneritete apo transaksione që nënkuptojnë shfrytëzimin e resurseve minerale. Këto dy sende mund të kërkojmë që Kuvendi të japë mendimin, jo për çdo kontratë, jo për çdo... se, atëherë kemi kaluar... ne ia kemi mbyllur, atëherë bordin menaxhues nuk kemi pse e emërojmë hiç.

Duhet Qeveria ta udhëheq krejt edhe u kry puna. Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm në do sende. Urdhëro, Besim. Vazhdo se ndoshta të ndërhyra.

BESIM BEQAJ: Mu për atë, që nuk dëshirojmë me e shti Kuvendin në mikro-menaxhim, sepse nëse thua lidhur me çështje që kanë të bëjnë me themelim, transformim dhe shuarje dhe nëse dëshironi me ia shtua tash “me marrë aprovimin paraprak të Kuvendit”, nënkupton që Kuvendi duhet të pyetet edhe për themelim edhe për shuarje të njërive. Çka po propozoj unë, është me thënë që lidhur me çështjet që kanë në themelimin, funksionimin dhe shuarjen e njërive, është komplet mikromenaxhim, të mbetet në nivel të Bordit Mbikëqyrës dhe merr leje nga Qeveria. Ndërsa, që lidhet me këtë, në nenin 12, ku flasim për mundësinë e pjesëmarrjes së sektorit privat, pikës 1 t’ia shtojmë pikën 2, ku themi se “procesi i transformimit dhe ristrukturimit të Ndërmarrjes “Trepça” të bëhet në harmoni me Ligjin për ndërmarrjet publike, që nënkupton marrjen e aprovimit të Kuvendit.”

KRYETARI: Ah, jo! Mos,

BESIM BEQAJ: Pse jo?

KRYETARI: Sepse ne po e fusim në sektorin privat këtu e jo me... si ndërmarrje publike, ajo është tjetër send. Jo, jo, këtë që po thua ti, këtë duhet me e shti këtu, se... cila ishte e para, qatë... po pajtohem me ... funksionimin. Të lutem, ngadale, veç të jemi kështu... “funksionim”, po pajtohem me Besimin, ndryshohet “funksionimi”. Menjëherë, po e shkruajmë pikën tjetër lidhur me transformimin, qaty menjëherë te “bordi”, “lidhur me transformimin” e qysh e the, ku e pate Besim?

FATMIR REXHEPI: Kryetar po e kryjmi nihere te parën.

BESIM BEQAJ: Procesi i transformimit dhe ristrukturimit të Ndërmarrjes “Trepça” bëhet në harmoni me Ligjin mbi ndërmarrjet publike.

KRYETARI: Jo, jo, Kuvendi mundet me marrë masa. Lidhur me transformimin dhe ristrukturimin e njërive biznese, a si po themi, kjo nënkupton privatizimin dhe ristrukturimin, Bordi Mbikëqyrës duhet të marrë pëlqimin e Kuvendit. Pajtohem! Veç transformim, po ristrukturimi nganjëherë nuk është edhe transformim. Për transformim pajtohem. Ristrukturimi mund të jetë mikromenaxhment.

RAIF QELA: Veç, kjo qysh është thënë, mendoj që është më...

KRYETARI: Po, ti po mendon, po kur ta kryejmë mbledhjen e diskutojmë unë e ti. Ngadalë, merreni fjalën. Deputet, po. Urdhëro!

RAIF QELA: Ligjin për ndërmarrjet publike është pikërisht kjo që transformimi mund të bëhet përmes votës së Kuvendit. Prandaj, është e thënë më juridikisht, po më duket, kjo se sa të themi, ta përmendim këtu Kuvendin.

BESIM BEQAJ: Edhe një detaj, kryesues. Ne kemi ndërmarrje që janë ndërmarrje publike në Kosovë. Procesi i transformimit të ndërmarrjes, nëse dëshirojmë t'ia lëmë komplet fuqinë e vendimarrjes Kuvendit, sepse Ligji për ndërmarrjet publike e përcakton formën e shitjes së aksioneve të ndërmarrjeve publike, të cilat shndërrohen në shoqëri aksionare. Kështu funksionon PTK-ja, kështu funksionon KEK-u, kështu funksionojnë ndërmarrjet tjera.

KRYETARI: Mirëpo, ne e kemi ligjin e veçantë për “Trepçën”, prandaj e kam sjellë këtu Ligjin e veçantë për “Trepçën”. Ne mund t'i japim ato, po nuk po... këtu është... Bordi Mbikëqyrës çfarë mund të bëjë. Ne kemi thënë, që s'mund të bëjë transformim pa lejen e Kuvendit, pajtohem me këtë e jo atje të flasim për sektorin privat.

BESIM BEQAJ: Jo, jo, veç pak...

KRYETARI: Po, kemi nevojë, e kemi hapur Ligjin e ndërmarrjeve publike te kapitulli i sektorit privat.

BESIM BEQAJ: Sektori privat duhet të hyjë në bazën e një ligji, dëgjoni. E ke ligj relevantë, në përkufizim e ke Ligjin e ndërmarrjeve publike, ose Ligjin e shoqërive tregtare. Nëse don me e shti në sektor privat, duhet me u bë mbi bazën e Ligjit të ndërmarrjeve publike, sepse ajo lejon me i shitë aksionet.

KRYETARI: Ajo ka me u ba. Ju lutem, urdhëro Visar.

VISAR YMERI: Veç me e shtu këtë transformimin, ristrukturimin, përfshirë ndryshimin eksportues aksionar...

KRYETARI: Jo, të aksionarëve...

VISAR YMERI: Ka, ka, ka mundësi me pas propozime në të ardhmen. Strukturat që që këtu duhet me qenë “vendimet e Kuvendit”, në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike. Domethënë, procedurat janë të gatshme me Ligjin për ndërmarrjet publike edhe me e ravigjzua edhe një herë në këtë ligj, sepse i kemi aty.

ENVER HOTI : Po e marr një mundësi, të ndihmoj ndoshta pak. E kemi një propozim, po më duket, për nenin 9, nga profesor Haliti. Është mirë me e trajtue nenin 9, paragrafin 9. E kemi aty, është mirë ta trajtojmë. Po, mirë është me e trajtue...

KRYETARI: Po me e trajtua, po, duhet ta absorbojmë. Në dy tre vende e kemi absorbuar. Ky është mikromenaxhim. Po, po, ashtu, mirë, faleminderit që na e tërhoqe vërejtjen. Ne pjesët e këtij ligji do t'i absorbojmë. Po. Urdhëro, Sala!

SALA BERISHA-SHALA: Këtu te neni 9, paragrafi 3, e kemi një amendament që mendoj se duhet të futet, se është shumë i rëndësishëm.

KRYETARI: Cili?

SALA BERISHA-SHALA: E ka bërë deputeti Shpëtim Bulliqi dhe thotë: “nenit 9 t'i shtohet paragrafi 3, te “fushat e ekspertizës”, të shtohet edhe “fusha e gjeo-shkencës”.

KRYETARI: Le ta kryejmë këtë njëherë, pastaj...

SALA BERISHA-SHALA: Eh, po kemi shkuar te nëntëshi pa e trajtuar këtë...

KRYETARI: Ne jemi te pika tre, le ta kryejmë këtë... kur ta kryejmë pikën që e nisëm, pikën 9, pastaj po dalim te pika 3. Jo, jo, s'e kemi kryer. Kur të themi se e kryem nenin 9, e kemi kryer edhe pikën 3.

Jemi në pikën 9, ta kryejmë pikën 9.

BESIM BEQAJ: A po e lëmë veç “funksionim”?

KRYETARI: Po, vetëm “funksionim” edhe këtë me “funksionim” po e lëmë edhe po i shtojmë këto “transformimi dhe ristrukturimi kërkojnë pëlqimin e Kuvendit.”

GLAUK KONJUFCA: Unë e kam një amendament për këtë.

BESIM BEQAJ: Jo, s'është amendament. Unë nuk pajtohem, po më vjen keq. Nëse kështu... nuk kam problem, të gjithë le t'i thonë mendimet e veta, unë nëse ashtu, do t'ia prezantoj edhe Kuvendit, si amendament të veçantë.

GLAUK KONJUFCA: ... të veçantë, pa përkrahje...

BESIM BEQAJ: Por, çfarë unë po propozoj, është që pika 9 e nenit 9, edhe një herë po e lexoj në tërësi: “deri te çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, funksionimin dhe shuarjen e njësive biznesore dhe investimet në projekte të reja, Bordi Mbikëqyrës merr aprovimin”, “lejen” a qysh të doni, “e Qeverisë si aksionar kryesor.”

Meqenëse, kemi të bëjmë me këtë bordin, por bordi nuk mund të marrë vendim për tjetërsim të aksioneve. Nuk hyn hiç në këtë pikë. Unë po propozoj, kur flasim për futjen e sektorit privat, atëherë duhet me u caktua qysh hyn në sektorin privat.

RAIF QELA : Në bazë të cilit ligj...

BESIM BEQAJ: Kështu që, unë po e qes në propozim votimin, njëherë të pikës 9, po propozoj se ju e qitni në votim, si të tillë dhe kur të vijmë te neni 12, pastaj po e diskutojmë edhe një herë.

KRYETARI: Jo, ne këtu kemi pasur me e involvua edhe Kuvendin, po kemi edhe amendamente të deputetëve të tjerë.

BESIM BEQAJ: Po, mundesh me involvu...

KRYETARI: Të lutem, tash, ti fole e prit pak. Po vazhdojmë.

Domethënë, kemi disa amendamente. Është një amendament i juaji, që pjesën e parë e absorbuan, pjesën e dytë po shikojmë ku është më e arsyeshme me e absorbua. Kështu që, veç të mos kalojmë në....dhe të ecim ngadalë.

E kemi amendamentin e profesor Hamitit, që mua më duhet ta lexoj këtu, se s'di a e keni marrë të gjithë, a kam nevojë ta lexoj.

GLAUK KONJUFCA: Është mirë me e lexua.

KRYETARI: Po, vetëm se ky e konstatuam që ka mikromenaxhim në pjesën e fundit. E keni një amendament timin, lexojeni.

Kemi diskutuar, “vendimet që ndërlidhen me investimet të partneritetit për eksploatimin dhe shfrytëzimin e mineraleve të “Trepçës”, Bordi Mbikëqyrës mund t'i marrë vetëm pasi që ta marrë pëlqimin e Kuvendit të Kosovës.”

BESIM BEQAJ: Edhe një herë, profesor, lexojeni, ju lutem!

KRYETARI: Amendamenti im është “Vendimet që ndërlidhen me investimet dhe partneritetin për eksplorimin dhe shfrytëzimin e mineraleve të “Trepçës”, Bordi Mbikëqyrës mund t'i marrë vetëm pasi të merret pëlqimi i Kuvendit të Kosovës.”

BESIM BEQAJ: Mirë është.

KRYETARI: Këtë e caktojmë te mineralet, jo te çdo transaksion biznesor, se atëherë hyn në mikromenaxhim...

RAIF QELA: Besoj që ... kjo përfshinë edhe Hamiti, po

KRYETARI: Edhe të Besimit, po...

SALA BERISHA SHALA: Kryetar, veç rregulloje, se këtu e kemi na “eksploatimin dhe shfrytëzimin” që është e njëjtë.

KRYETARI: Shfrytëzimin, ... ah të mineraleve, edhe ajo shfrytëzimi i metaleve atje, që mund me qenë transaksion biznesor, ... nuk është problem.

SALA BERISHA SHALA: Veç pak, qëllimi ka qenë me thënë “hulumtimi dhe shfrytëzimin”.

KRYETARI: Ah, u bë. Domethënë, ndërlihem në investime për “hulumtimin dhe shfrytëzimin” mirë “eksplorimin”.

Mirë, e aprovuam. A pajtohem me e heq këtë “funksionimin” aty, se është mikromenaxhment. Po? Veç pak...

BESIM BEQAJ: Kryetar, edhe një herë.

KRYETARI: Ngadalë de tash. Ngadalë, se unë po, po, po e heqim “funksionimin”, Besim.

BESIM BEQAJ: Ani, hjekne...

KRYETARI: Qe... një herë duhet me votua për me e heq. Domethënë, kush është për me e heq, me e fut fjalën “funksionim” në vend të asaj “transformim”. Transformimin, domethënë nuk mundet me e bë, pajtohem, Bordi.

FATMIR REXHEPI: A e votojmë këtë?

KRYETARI: Po, këtë po e bëjmë. “Transformimi” hiqet prej atyhit, po pajtohem të gjithë. Mbikëqyrës edhe s’mundet veç Qeveria, pajtohem le të vijë në Kuvend. U bë puna.

Tash, thamë: “vendimet që ndërlihen me investimet ... i kemi ... , vetëm pasi të merret pëlqimi i Kuvendit të Kosovës.” A pajtohem me këtë?

BESIM BEQAJ: Veç një mendim.

KRYETARI: Po, urdhëro Besim. Urdhëro, se tash e akomodojmë ne.

BESIM BEQAJ: Dëgjo, si amendament është në rregull, por unë po besoj që është më mirë me e qua te neni 12. Pse po e them është më mirë me e qua? Sepse, këtu po flet për aranzhmane kontraktuale, që bordi mundet me bë, këtu po flet për fuqi tregtare, këtu po flet për partneritet strategjik, këtu po flet për sistemet bursa të tregjeve botërore.

Dhe, tash atje e ke diçka me funksionim me mikromenaxhim, ndërsa kur po flet për nenin 12, për çfarë, çka mund të bëjë bordi i cili paraprakisht duhet ta marrë një vendim të Kuvendit, unë po besoj që vendin e ka këtu, veç nëse doni me thënë “në harmoni me ndërmarrjet publike, në ... me ndërmarrjet publike, nuk ndonjë farë dallimi shumë të madh, a merr vendimin paraprak ...

KRYETARI: Mirë, atë po e shikojmë ne edhe në sektorin privat. Ju lutem, “vendimet që ndërlihen me investimet e partneritetit për hulumtim dhe shfrytëzim të mineraleve të “Trepçës”, Bordi Mbikëqyrës mund t’i marrë vetëm pasi të merret pëlqimi i Kuvendit të Kosovës.” A jemi dakord me këtë? Kush është për? Faleminderit!

BESIM BEQAJ: Ku e me e qit?

KRYETARI: Këtu de, pse... autorizimet e bordit, që s'mund të vendos për këtë, pa marrë pëlqim. Eh...Eh tash, shkojmë te "transformimet" dhe vijmë aty, se mund të themi këtu "transformimet" që munden me qenë edhe në partneritetin, atje ku i kemi, Ligjin për ndërmarrje... Po, s'është.

BESIM BEQAJ: S'ka nevojë dy herë...

KRYETARI: Cili nen është... jo, se kjo nuk është, kjo është për komunalet, a partneriteti mund me qenë më i gjerë. Unë dua me e kufizua rolin e Kuvendit në pasuritë natyrore.

RRUSTEM BERISHA: Mendoj se është pika në pyetje, se të njëjtin gjë jemi tu e than.

KRYETARI: Jo, jo, s'e kemi këtu të njëjtën gjë, se këtu nuk flet për transformimin, e mund të transformohet edhe Shkrijetorja, mund me u transformua edhe tjetra, mund të transformohen shumë sende. S'jemi në të njëjtën gjë. Unë po them, që me i mbrojt mineralet.

Mandej, në qoftë se duhet e vlerësojmë, e votojmë edhe atë. U kry puna. A pajtohemi? Visar, mund me ... Urdhëro!

VISAR YMERI: Këtu, ose po flasim për njësitë biznesore e s'po flasim për "Trepçën"SHA. Nëse flasim për "Trepçën" SHA, deputeti Beqaj e ka mirë. Çfarëdo transformimi i "Trepçës" SHA, ose i njësive biznesore, i pjesshëm, i plotë, e kështu me radhë... duhet me qenë vendim i Kuvendit. Kjo është. Shkon te neni 12 më shumë se sa te neni 9.

KRYETARI: Kjo nuk cakton pasuritë natyrore, kompetencat e bordit po i cakton.

VISAR YMERI: Po, por unë po flas për "Trepçën" SHA në përgjithësi.

KRYETARI: Ne jemi duke folur për bordin mbikëqyrës, për kompetencat e tij, që ai s'mund të vendosë këto punë pa marrë pëlqim të Kuvendit. U kry. Kush është për këtë? Dy, tre, katër... Kush është kundër? Kalon! Faleminderit!

Kur të vijmë atje, e trajtojmë nenin 12.

Dalim te pika 3. Deputetja Sala Berisha. Gjeni a ka të tjera.

SALA BERISHA SHALA: Amendamenti është i deputetit Shpetim Bulliqi, që bie natyrisht edhe në fushën të cilën e kam profesion dhe është... jo, jo nuk është... neni 9, kryetar, është neni 9, pika 3, t'i shtohet edhe "fusha e gjeo-shkencave". Veç diçka duhet sqaruar. Gjeo-shkenca është çelës i të gjitha veprimeve, operimeve tjera...

KRYETARI: Çka është kjo? A është gjeologjia?

SALA BERISHA-SHALA: Gjeologjia.

KRYETARI: Gjeologjia, inxhinierët e xehetarisë?

SALA BERISHA-SHALA: Të gjeologjisë, jo të xehetarisë. Gjeologu e hulumton një herë çka ka, pastaj xehetari e përpunon. Është propozim me vend.

KRYETARI: Faleminderit! Po, por ne kemi thënë “teknike dhe teknologjike, që specifikohen në Statutin e “Trepçës”, cilat profesione? Mos t’i ngushtojmë këtu në statut, se pastaj duhet me shkrua “inxhinierët e elektronikës”, tani duhet me pas gjithfarë...

SALA BERISHA-SHALA: Jo, jo nuk ngushtohet. Kryetar, më dëgjo!

KRYETARI: Po, teknike i ke njëqind. Edhe gjeo-shkenca është teknike.

SALA BERISHA-SHALA: Kryetar, dëgjom! Nuk të prishë punë, nuk ta dëmton ligjin...

KRYETARI: Po, s’prishë punë, po pse me e specifikua veç një?

SALA BERISHA: Atëherë, s’po e specifikojmë as ekonominë, as drejtësinë...

KRYETARI: Jo, jo, teknikën duhet me e specifikua, patjetër.

SALA BERISHA-SHALA: Teknologjia është diçka tjetër. Gjeologjia... Më dëgjo, më dëgjo, teknologjia është diçka tjetër, është shkencë tjetër, gjeologjia është shkencë tjetër. Kryetar, nuk prishë punë, nëse nuk don me e fut amendamentin.

KRYETARI: O nuk prishë punë, po na qet telashe, se nesër lyp edhe secili profesion me shku atje.

SALA BERISHA-SHALA: Jo, jo nuk është telashe. Më dëgjo, nëse nuk don me e fut amendamentin për shkak të personit që e ka propozuar, është diçka tjetër,

KRYETARI: Jo, jo, më fal, të lutem! Nuk është, s’ka lidhje, unë po e arsyetoj.

SALA BERISHA-SHALA: Por, ky amendament veç e përmbushë, e plotëson...

KRYETARI: Mos ta ashpërsojmë menjëherë, mos... ti nuk mundesh me e ditë a dua dhe për çka nuk dua. Unë e arsyetove për çka nuk dua, prandaj kufizohu në atë që thash unë.

SALA BERISHA-SHALA: Atëherë, qite në votim.

KRYETARI: E qesim në votim.

RAIF QELA: Profesor, a bën veç pak.

KRYETARI: Po e qesim në votim. Urdhëro, se duhet me e krye këtë punë. Edhe në ekonomi ka marketing, ka menaxhment, ka banka, ka njëqind profesione. Statuti i “Trepçës” i cakton ato. Të lutem!

SALA BERISHA-SHALA: Kryetar, veç pak, veç pak diçka, në gjeologji ka, hidro-gjeologji, ka seizmi, ka ... ,

KRYETARI: Qashtu, edhe në marketing ka marketing on-line, ka marketing...

SALA BERISHA-SHALA: I ka nja dhjetë fusha gjeologjia...

KRYETARI: Ju lutem, e qes në vota propozimin e zotit Bulliqi. Kush është për? Tri vota për. Gjashtë vota për. Unë jam kundër edhe kam me i bind deputetët të votojnë kundër. ... t’i votojmë sendet qysh janë, reale. Po, s’mundet me qenë, jo, jo, me shumicë të votave mirë, përkrahet kjo, por nuk është kjo ... gjeo-shkenca...

SALA BERISHA-SHALA: Në qoftë se s’e ke gjeoshkencën as ... s’mundeni me bë...

KRYETARI: Shkruajeni, gjeoshkencën atje le të votojnë deputetët si të duan. Shkojmë më tutje.

GLAUK KONJUFCA: Kryetar, unë e kam te 9.9-shi një.

KRYETARI: Te nëntëshi, 9.9. perseri.

GLAUK KONJUFCA: Se, edhe Sabri Hamiti e ka një, po edhe unë e kam një.

KRYETARI: E kryem atë,

GLAUK KONJUFCA: Jo, jo, ai ka qenë amendamenti juaj, unë e kam timin. Pse, po thotë këtu tash, kur kryhet këtu, që po thotë “te Bordi Mbikëqyrës”, krejt ato që u përmendën, domethënë “transformimi”, “themelimi”, “shuarja” e këtyre njërive biznesore, e të tjera, tash “Bordi mbikëqyrës” unë po them, “, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës, si aksionari kryesor, duhet ta marrë miratimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.” dhe kjo nuk është mikromenaxhim.

KRYETARI: Kjo është. E hoqëm “transformimin” dhe i shkruam ato pasuritë natyrore. E keni propozimin, kush është, unë mendoj që e kemi absorbuar edhe idenë e profesor Hamitit. E kemi propozimin, megjithatë duhet të deklarohemi. Kush është për propozimin e “Vetëvendosje” Ju lutem, ka të drejtë të insistojë në amendament. Po, e kemi propozimin. Kush është për, le ta ngrejë dorën. Mirë, pa përkrahje të komisionit.

Ne jemi kolegë, ... me i plotësua standardet profesionale, jo iniciativave individuale, ... se nesër nuk po dua me pa unë, me projektua njerëzit, individët nëpër organe. Ne e kemi lënë hapësirën me statut me u rregullua kërkesat specifike. Dhe, ju lutem...

BESIM BEQAJ: A të shkojmë te neni 10?

KRYETARI: Po shkojmë. Po, t'i zbatojmë do parime qysh duhet të punojmë.

BESIM BEQAJ: Unë te neni 10 e kam një amendament.

KRYETARI: Urdhëro, eh këtu po, mirë e ke. Hajde të shohim mos po përputhet me amendamentin tim.

BESIM BEQAJ: Të hiqet fjala “ndihmësit e tij”. Bordi menaxhues përbëhet nga kryeshefi ekzekutiv, zëvendësi dhe udhëheqësit e njësive biznesore.

GLAUK KONJUFCA: Në cilin paragraf?

BESIM BEQAJ: Paragrafi i parë.

KRYETARI: Ndoshta ka nevojë me qenë prej financave. Hajde ai mund t'i thërrasë edhe ashtu, që të marrin pjesë. Po, veç këtu nuk e kemi caktuar këtë nenin për....

Zbatohen kriteret, atë që e kemi.. jo mbikëqyrës janë patjetër, s'kanë qare pa kanë aty.

RRUSTEM BERISHA: Edhe unë e kam një propozim.

KRYETARI: Mirë, e dëgjuam propozimin e Besimit.

Kush është për? I heqim ligjit “zëvendës janë drejtorët e njësive”.

RRUSTEM BERISHA: Edhe unë e kam një propozim. Te neni 1, paragrafi 1, propozoj që të futet këtu edhe kryetari i sindikatës së Trepçës. Është neni 10, paragrafi 1.

KRYETARI: Duhet me qenë në bord mbikëqyrës, jo në menaxhim. Në bord ke të drejtë, dhe atje punëtorët e zgjedhin. Por në bord të Trepçës 20% të anëtarëve do të jenë të sindikatës...

RRUSTEM BERISHA: A mund ta fusim atje, te Bordi mbikëqyrës.

KRYETARI: Punëtorët i kanë, 20% i kanë.

(Polemikë)

KRYETARI: Ju lutem shkojmë më tutje. Unë mendoj që s'ka nevojë të hyjë përfaqësuesi i sindikatave.

RRUSTEM BERISHA: Jo, po mendoj për bord mbikëqyrës.

KRYETARI: Jo, në bord mbikëqyrës hyn patjetër, s'kanë qare...

KRYETARI: Ju faleminderit, vazhdojmë! Unë kam menduar, do të tërhiqem se këtu po ashtu kryeshefi ekzekutiv duhet t'i nënshtrohet normave të konfliktit të interesit dhe e ... të karakterit politik.

GLAUK KONJUFCA: E këto tuajat kur kanë qenë, pse s'i ke bërë saktë në cilin nen.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Unë i kam bërë për komision, nuk quhen amendamente të mia. Qe, edhe Besimi po i shtin te Komisionit.

(Polemikë)

11. Njësitë biznesore...

BESIM BEQAJ: I kemi qit në tri pikat e para.

KRYETARI: Bravo, e në të dytën?

(Ndërhyrje)

ENVER HOTI: E kam një propozim. Te neni 11, por propozimi ynë është kështu, tërë njësitet biznesore janë të obliguar në të gjitha rrethanat, në përparësi i përpunojnë koncentratet e minierave të Trepçës, sepse mund të kenë edhe koncentrate të tjera, që mund të jenë me përparësi.

(Polemikë)

KRYETARI: Po kusht është, kusht është me e u furniziu. Ne kemi thënë që me i përpunuar sendet në Kosovë, mos me i çu me i shit, pra me krijua vende të punës, këtu është problemi. Kështu që e kemi absolvu... Enver atë.!

Mirë, a ka ndonjë amendament tjetër këtu? Visar?

VISAR YMERI: Jemi te neni 11, nuk kam amendament por po dua ta ngris një çështje. Do të thotë 11.6. Paragrafi 6 thotë ... dividendi që u takon aksionarëve.... për aksione evidentohet dhe paguhet në nivel të njësisë biznesore duke u bazuar në rezultatin financiar të saj.

Kjo më shumë nënkupton ose nënkupton një autonomi shumë më të madhe të njësive biznesore se sa që është realizuar tjetërkund në ligj, se këtu dividenda nuk po ndahet në nivel të Trepçës SHA, por të njësive biznesore, që nënkupton se secila njësi biznesore mund të vendosë...

KRYETARI: E ka devidencën nën llogari, por jo llogari në bankë, s'ka konto. Konto është vetëm e Trepçës, në vend të llogarisë.

VISAR YMERI: Dividenda është e aksionarëve.

KRYETARI: Po, vlera e aksioneve, e ke tjetërkund. Vazhdo, kryeje...e pastaj e shpjegojmë.

VISAR YMERI: ... Do të jenë, thotë jo reperkusione do të jenë, jo fort te aksionari, e Qeveria në këtë rast, por te punëtorët të cilët dividendën e marrin prej njësisë biznesore ku janë të punësuar, që nënkupton se ka me pas raste kur disa punëtorë kanë me marrë dividendën... e tjerët jo.

KRYETARI: Jo, në qoftë se s'ka fitim. Dhe e dyta, që edhe pse është kjo. Kemi një disproportin, dhe ju lutem më dëgjoni. Visar dëgjo!

Ju lutem, i kemi tash disa njësi që kanë numër hiq proporcional të punëtorëve, domethënë në njësi ka... s'po dua me i përmend emrat, 2.700 tjetra i ka kapacitetet më të mëdha, i ka 1.500, prandaj ne i kemi lidhë me njësitë biznesore, jo me Trepçën krejt minatorët. Është arsyeja dhe ta shpjegoj. Dhe kjo e ka logjikën ekonomike, dhe kjo është njësi llogaritëse, njësi llogaritëse që është stimulative për punëtorët në njësi me punua më mirë, me fitim, marrin dividendë.

Këta që harxhojnë, s'punojnë, e se kontrollojnë menaxhmentin dhe as s'mërziten, s'kanë fitim, s'kanë dividendë. U krye puna!

VISAR YMERI: E kjo ndikon pastaj në vlerën e Trepçës me marrë në përgjegjësi, apo jo.

KRYETARI: E bordi mbikëqyrës i bën proporcionet deri ku do të shkojë kjo. Jo, është atje, këqyre, thotë i aprovon planet financiare dhe proporcionet Bordi mbikëqyrës i njësiteve. Janë lidhur sendet bukur mirë.

Po vazhdojmë. Ju faleminderit. Kalojmë në nenin 12. Për nenin 12, kolegu Besim urdhëroni!

BESIM BEQAJ : Faleminderit kryetar!

ARBEN LIMANI – AKP: Po te neni 11 nuk është e qartë se kur këto njësi themelohen. Arsyeja pse, ne mendojmë se duhet pasur komisioni sepse meqë neni 2 me automatizëm me ... numër këto njësi i themelon si njësi të shoqërisë aksionare, e neni 11 e lë hapur që vetëm pas studimit të fizibilitetit bëhet themelimi i tyre.

KRYETARI: Po, i kujt?

ARBEN LIMANI – AKP: Problemi i njësive të metalurgjisë së plumbit, zingut dhe ...

KRYETARI: Po, sigurisht!

ARBEN LIMANI – AKP: Po problemi është ky, se me 2 nëntor të gjitha njësitë tjera të cilat nuk janë të themeluara si njësi të shoqërisë aksionare të Trepçës rrezikojnë të hyjnë në likuidim ... me vendim të dhomës së posaçme sipas moratoriumit....

KRYETARI: E shohim atë çështje, e zgjidhim ndryshe.

(Ndërhyrje: Ka të drejtë!)

Po s'ka të drejtë. Kur s'mund me bë me automatizëm se shkritoren për shembull në iks vende, studim i fizibilitetit do të thotë që s'kemi ndërtuar atje hiq, po e ndërton tjetërkush.

E dyta, borxhet e mëdha që i ka në ... shkritore ... ne nuk mund t'i marrim automatikisht tash, po ndoshta atë e lëmë te Agjencia e Privatizimit megjithëse këto mbeturina shiten dhe i paguan borxhet që janë, vlera është zero, borxhet janë 1 milion dhe s'paguhen borxhet hiq. A u kuptuam? Do të thotë këtu janë disa sende... A u kuptuam tash? Shumë mirë, dhe besoj që u kuptuam!

(Ndërhyrje)

Për nenin 12 e ka fjalën Besimi.

BESIM BEQAJ: Unë e thashë edhe më herët, por po e përsëris. Tek neni 12, pas pikës 1, propozimi nëse dështohet një pikë 2 e re... thotë – procesi i transformimit dhe strukturimit të ndërmarrjes Trepça SHA bëhet në harmoni me Ligjin për vendimmarrjet publike.

Dhe .. folë partneritetin për mbi popullatë, investimet po bëhen... shitja e aksioneve...

KRYETARI: Atëherë duhet të përmendim, investimet e jashtme, ligji mbi vlerat, duhet me përmend krejt, se nuk i nxen vetëm Ligji i ndërmarrjeve publike, aty e kisha hallin unë, më mirë dojsha me dërguar, por e çuam atje në fakt por në qoftë se duhet atje e forcojmë. Do të thotë problemi, ndërmarrjet publike këtu nuk mund t'i servisojnë krejt këto forma, Ligji i ndërmarrjeve publike, kam frikën unë, por të shohim.

BESIM BEQAJ: Atëherë, po themi procesi i transformimit të ndërmarrjes Trepça bëhet me aprovim paraprak të Kuvendit.

KRYETARI: Proceset që kanë të bëjnë me transformim, e shkruajmë atje lartë. Vendimet për transformim, mund t'ia shtojmë atë... të pasurive natyrore dhe vendimet e transformimit, dhe shtone atje, transformimi. Këtu e kisha hallin Besim. Faleminderit!

BESIM BEQAJ: Vetëm ta sqarojmë dhe të jemi të qartë. Do të thotë te neni 9, kur flasim për vendimet e bordit edhe për transformim merren me vendim paraprak të Kuvendit.

KRYETARI: Po, shfrytëzimi i pasurive minerale dhe transformimet.... U pajtuam do të thotë. Aty desha unë të ndërhyj, por jemi pak me tensione, dhe s'kemi faj, s'jemi lodh.

(Polemikë)

Në rregull, shkojmë më tej. Faleminderit! A pajtohem ta votojmë këtë amendamentin që e bëmë për pasuritë natyrore, te pika 9 të shtohet edhe – transformimet pronësore. Në rregull!

Pra, kush është për? Faleminderit! U pajtuam!
E tash, a ka ndokush tjetër diçka për nenin 12.

GLAUK KONJUFCA: Po mendoj se e kemi bënë një gabim procedural, se amendamentin e zotit Sabri Hamiti nuk e kemi shqyrtuar hiq.

KRYETARI: Pajtohem! Ne po mendojmë se amendamenti i zotit Sabri Hamiti është absolut në të dy amendamentet në tërësi. Mirëpo, nëse insistoni, e shkruajmë në raport Sabri.

SABRI HAMITI: Jo bre, pasi ju keni vendos mos me i shkruajt....

KRYETARI: Jo, e themi atje që nuk është absolutuar dhe përkrah por është përfshirë në amendamentet e Projektligjit.

GLAUK KONJUFCA: Po, pe di, por u në s'pajtohem pa e pyet deputetin se çka mendon ai, a po absolutohet apo jo. Sepse, për shembull ai nuk pajtohet, ndoshta do në mënyrë qysh e ka formuluar ai të pranohet, në seancë. E ai s'ishte këtu i pranishëm...

KRYETARI: Shkruani në raport amendamentin e profesor Hamitit. E dyta, shkruani mendimin e shumicës së komisionit që përmbajtja e amendamentit është absolutuar në këtë pikë, e në këtë pikë. Dhe, mund të insistohet të votohet amendamenti atje. A jeni dakord?

GLAUK KONJUFCA: Tash, te 12 e kam një mendim. Te 12, këtu te Trepça, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e saj, të shtojmë në katër kategori, të cilat i parasheh ligji si forma qysh i qaset këtij qëllimi, që është partneriteti publiko-privat, investimet direkte, investimet e përbashkëta dhe emetimi dhe shitja e aksioneve.

Unë po mendoj që përmes amendamentit tim me ia shtu këtyre katër kategorive të para edhe tri, që do të jenë: kreditë shtetërore, kreditë e kompanisë dhe emetimin e shitjen e obligacioneve, si forma të cilat po ashtu mund të jenë që t'i kontribuojnë shumë këtij qëllimi.

KRYETARI: Më s'po flasim këtu për burime të financimit të investimeve. Burimet e financimit të investimeve caktohen me studim fizibiliteti dhe çdo organizatë mund të hyjë kredi, kur s'ka kredi shtetërore. E dyta, këto bonat e këto, mund me i emetua më vonë por mendoj....

BESIM BEQAJ: S mund me emetua bonat nëse s'është e regjistruar.

KRYETARI: Trepça s'mund të emeton bona. Mundet Qeveria të emetojë bonat.

(Ndërhyrje)

Po, kur të regjistrohet mundet. Emetimi dhe shitja e aksioneve me bona, edhe mund të bëhen dhe mundemi ta shkruajmë, regjistrimi që është letra me vlerë, në vend të aksioneve mund të jenë letrat me vlerë.

(Ndërhyrje)

Këtu po e bëj një përjashtim. Dardani është për letra me vlerë, dhe mundet lidhur me to diçka....

(Ndërhyrja)

VISAR YMERI: Kjo është ideja që i kemi propozua edhe me tri mënyra tjera të gjenerimit të kapitali për Trepçën nëse shihet e dobishme. Nuk e kufizon as obligon. Pra studimi i fizibilitetit mund të thotë që bën, dhe s'bën, mirëpo...

(Ndërhyrje: Po s'ia mohon këtë mundësi)

KRYETARI: Këtu s'po flasim për burimet e financimit, po flasim për sektorin privat.

VISAR YMERI: Po flasim për investime në Trepçë, në sektorin privat. Pse me e paragjykuar

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Me kredi shtetërore. Mundet edhe me buxhet, mund edhe me partneritetin publiko-privat, mundet me gjithçka, i kemi shkruar krejt. Por Trepça për të marrë kredi, ne me prurje me ligj, por s'e ka të ndaluar me marrë gjithkush kredi...

(Polemikë)

VISAR YMERI: Po si shoqëri aksionare, ne po themi se me ligjin aktual që e ka të drejtën 1.4... emetimi dhe shitja e aksionit. Kjo është e vetëkuptueshme, apo jo? Ju e keni shti në ligj.

KRYETARI: Po, por duhet t'i krijojë kushtet për t'u regjistruar. Dhe është punë shumë e madhe me mund të shet aksione, me u regjistrua atje.

VISAR YMERI: Mirë, por kur të regjistrohet, mund të regjistrohet...

(Ndërhyrje...)

KRYETARI: Mirë, nëse ka një letër me vlerë, ose vetëm me shkruajt letrat me vlerë, mundemi por më duket se është në rregull kjo... Kush ka ndonjë amendament? A jeni për këtë amendament? Unë si tërësi, ndoshta ndonjë element tjetër e ka prodhu, por si tërësi jo.

Në qoftë se i votoni të triat, unë pyes kush janë për amendamentet që i propozoi përfaqësuesi i Vetëvendosjes. Një votë për. Nuk kalon. Faleminderit!

Kalojmë në nenin 13.

Neni 13, përgjegjësia sociale të komuniteti, s'ka pasur kurrëgjë.

(Ndërhyrje)

Po, te neni 14, ku me i shti këto, sepse kemi pasur diskutim edhe në komision edhe në Parlament sot.

GLAUK KONJUFCA: Unë e pata një te 12j-shi.

KRYETARI: AKP, në ligj, për të marrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për të realizuar ... e Kosovës dhe Trepçës lidhur me asetet e Trepçës në vendet tjera.

SALA BERISHA - SHALA: Po a mundesh me këtë ligj me i aktivizua prej tyre...?

KRYETARI: Me i detyruar ato, në AKP janë ato tash.

SALA BERISHA - SHALA: Po veç në cilin nen janë ato?

KRYETARI: Deri sa s'i marrim, ato janë në AKP. E te cili nen, ia gjejmë vendin në ligj.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Pretendimet e kreditorëve.

BESIM BEQAJ: T'i shohim te pjesët tjera!

KRYETARI: Bash, te pjesët tjera. Pra te neni..., ky është 2. A aprovohet kjo pika e dytë?

BESIM BEQAJ: Ndërmarrja Trepça SHA, ... dhe të marrë masa ligjore për administrimin e asetëve të saj jashtë Republikës së Kosovës.

KRYETARI: ... jo me administrua, por gjeje një fjalë tjetër.

(Ndërhyrje)

Po s'mund të administrojë në Kroaci, as në Serbi... Ajo vetëm mund të paraqitet si pretendent, si kreditor, siç paraqitet në

(Ndërhyrje)

Dëgjoni edhe një herë, ta gjejmë formulimin, dhe çfarë mendoni për kërkesat e kreditorëve, a jemi në rregull a jo. Për këtë ju kemi thirrur...AKP duhet të ndërmarrë apo do të ndërmarrë, qysh të doni, aktivitetet e nevojshme për të realizuar të drejtat e Kosovës dhe të Trepçës lidhur me asetet e Trepçës në vendet tjera.

A jemi dakord? Kush është për? Kjo hyn të pika 2, të nenit 14.

Kalojmë në nenin 15, pretendimet e kreditorëve.

GLAUK KONJUFCA: Jo, s'më dhatë mundësinë te neni 12...

(Ndërhyrje)

Jo se ky doli te 13, pa më pyet mua, e çova doren s'ma dhatë fjalën! Pra, do të thotë te neni ... tash paragrafi 12, 3 dhe 4 unë po propozoj të fshihet.

KRYETARI: Po, 3 dhe 4.

GLAUK KONJUFCA: E kam fjalën për te 12-shi. Jo, sepse e kam të fundit këtë.

(Ndërhyrje)

12.3, 12.4 sepse po thotë krejt këtu ka lidhje me OJQ-të, me aranzhmane kontraktuale... Është neni 12.3 dhe 12.4... Nuk ka nevojë sepse këto rregullohen me Ligjin për ndërmarrjet publike.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Në një njësi ne nuk lejojmë të shkojë, për shembull, më shumë se 51 ose 50% mirëpo kemi nevoja ... për njësi për investime, me i bë 30%, 20%. Investitori i AKP, po unë investoj por në qoftë se ti ma len edhe mua një ndikim menaxhmenti, për çështje menaxhmenti, në teknologji ... por jo me marrë vendime, por menaxhim. Do të thotë kjo mund të jetë e dobishme, pa e rrezikuar pronën. S'po di a u kuptuam? Unë s'kisha thënë me e hjek.

(Polemikë)

Shkojmë te 15-shi.

(Ndërhyrje: Po qite në votim, se po kam qejf me e qit...)

Po e qesim në votim. Kush është për? Një votë. Faleminderit!

Shkojmë te kapitulli – pretendimet e kreditorëve, neni 15. A të shohim një herë çka ka thënë AKP?

Pra, të shohim se unë për këtë sot i kam çu... të shohim. Pra, lexoni propozimin e AKP, ju lutem, neni 15 – pretendimet ndaj ndërmarrësve të paraqitura... të trajtohen sipas ligjit. Pra, pas ... në detyrimet lidhur me Trepçën SHA ... në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike.

SALA BERISHA – SHALA: A është formulim i ri, apo i shtohen këto?

KRYETARI: Jo, ndryshon neni dhe kështu bëhet.

(Ndërhyrje)

Po de, shlyhet dhe bëhet si duhet. A jeni dakord, dhe a jeni të sigurt se është mirë kjo këtu, po them, pikën 3 të arsyetoni, sepse është pak vonë, s'mundemi ta lëshojmë pa e arsyetuar pikën 3. Urdhëroni, kush do ta arsyetojë nga ju?

AVNI JASHARI - AKP: Faleminderit kryetar i Komisionit,

Të nderuar deputetë,

Pjesa 3, ... në pjesën e pretendimeve ... i kemi paraqitur në 3 paragrafe. Këto janë arsyet. Ka kërkesa të kreditorit, pretendime kreditore të cilat janë dorëzuar tanimë në... në vitin 2012, 13, 14 dhe ato s'kanë nevojë të ridorëzohen.

Pretendime tjera kreditore mund të ketë për periudhën prej vitit 2014 e deri kur të hyjë ligji në fuqi dhe kjo është arsyeja...

KRYETARI: Është i ri, po.

AVNI JASHARI - AKP: Po, paragrafi 2 dhe mund të ketë pretendime të reja kreditore për shoqërinë aksionare Trepça – njësi biznesore prej datës kur hyn në fuqi deri sa të funksionalizohet, dhe atëherë trajtohet sipas ligjit mbi ndërmarrjet publike.

KRYETARI: Shumë mirë! Vetëm ma thoni një gjë, arsyen pse s'kemi shkua menjëherë t'i tërheqim... më së pari s'e dimë sa investime, ku duhet të bëhen, a duhet të bëhen shkëmbime a s'duhet të bëhen. E dyta, s'i dimë hale pretendimet e kreditorëve, pastaj bëhet kos-benefiti, ku është më mirë, kush është më mirë, dhe për këtë. Por këtu jemi të sigurt se te këto miniera dhe flotacione s'ka shumë pretendime kreditore, a është e saktë?

(Ndërhyrje)

E saktë! Faleminderit! Atëherë, e vë në votim amendamentin që e morëm sot. Ne rregull kalon.

(Ndërhyrje)

RRUSTEM BERISHA: Edhe ne e kemi pasur gati të njëjtë këtë amendament.

AVNI JASHARI - AKP: Është e rëndësishme të theksohet se ekspertët tanë ligjorë dhe financiarë na e kanë tërhequr vëmendjen që në rast të shitjes së pronave, jothelbësore dhe joprofitabile të cilat janë në nenin 14, të cilat do t'i trajtojë Agjencia, kush do të marrë përgjegjësinë për pagesën e kërkesave kreditore në rast se nga shuma e shitjeve nuk mjaftojnë me i pagua kreditorët.

KRYETARI: Ju e keni ligjin për privatizim, e zbatoni ligjin, dhe që paguhen vetëm aq sa ka në fond të shitjes. U krye puna. Kjo është në ligj atje, s'mundeni ndryshe. Ju kanë tërhequr vëmendjen, ashtu duhet të veprohet, qysh është ligji, sipas ligjet tuaja i trajton AKP sipas ligjit, ai është ligj për ju. Prandaj, aty s'ka problem.

Pra, kush është për këtë? Aprovohet!

(Polemikë)

Atëherë, konstatoj se i kemi eksploruar dhe i kemi aprovuar të gjitha amendamentet.

RRUSTEM BERISHA: A bën edhe një ndërhyrje vetëm te neni 18, nëse bën, për një ndryshim? Aty ka të bëjë me afatin njëvjeçar. Pra, ato nënligjet, të shkurtohen në 3 muaj. Është në nenin 18. Janë në aktet nënligjore... është për 1 vit, mendoj të bëhen nga 3 muaj.

KRYETARI: Mund të bëhen edhe për 3 muaj, nuk ndalohet kjo.

RRUSTEM BERISHA: Por duhet me e shti aty, sepse ka presion.

KRYETARI: Ani, i thërrasim në interpelancë....

SALA BERISHA - SHALA: Kryetar, një pyetje...!

(Polemikë)

KRYETARI: Sabri, a keni me thënë diçka? Fatmir ulu...

SABRI HAMITI: Unë i mora tre propozime që duken këtu se janë bë për atë që e kam bë edhe unë - varianti. Ky i Beqajt s'është variant, është qysh ka qenë. Domethënë, neni ... paragrafi 9, ky s'është.... Unë e shoh që Vetëvendosja e ka propozuar një variant 9.9-shit...

(Ndërhyrje: Po, e afërt është me atë)

SABRI HAMITI: Po de, po. Një variant është. Dhe më tregoni ku janë këto, unë...

KRYETARI: Janë në dy-tre vende, në një vend është – Statutin e Trepçës e aprovon Kuvendi. Nën një. Nën dy. Të gjitha vendimet, që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pasurive natyrore, edhe me transformim, do të thotë me privatizimet, i merr Kuvendi i Kosovës. E tash, ai neni që ju ... na e tregoni amendamentin ka të bëjë me transaksione afariste që e përbëjnë një mikro-menaxhment ku Kuvendi s'ka nevojë të infiltrohet. Ky është sqarimi, dhe besoj se pajtohemi me këtë sqarim, e nëse domi, e diskutojmë tash bashkë, mundemi edhe në Kuvend.

SABRI HAMITI: Po, s'ka problem, por mua po më intereson materia!

KRYETARI: Po materien, në tre vende e kemi zbërthyer më mirë. Dhe e kemi përfshirë tërë atë idenë tënde. Janë do ... do transaksione që s'ka nevojë të shkohet në Kuvend se humbet shumë kohë dhe pastaj me shkua Trepça në humbje na thotë – ju keni harxhuar kaq shumë kohë, urdhëroni mi mbuloni humbjet.

GLAUK KONJUFCA: Edhe mua më thanë kështu, - edhe amendamenti i yt është shtrirë në këto tjerat, por unë s'pranova, thashë jo qitmani ashtu si e kam propozuar.

KRYETARI: Atëherë, ju lus kush është për Ligjin... me amendamentet në tërësi?

SABRI HAMITI: Po t'i mundesh me shkrua, s'e ka pranuar komisioni, por lexoje atje.

KRYETARI: Na e shkruajmë...

SABRI HAMITI: Po shkruane ju atje: – Sabri Hamiti, pa pëlqimin e Komisionit.

KRYETARI: Pa pëlqimin e komisionit dhe të absolvuar në amendamentet tjera. Ju lutem, ashtu shkruane. Unë e sqaroj që e kemi shkruar ashtu.

Pra, kush është për amendamentet në tërësi. Fatmir ju lutem...

SABRI HAMITI: ... mos me e propozue atje. Ai 18-shi, bëne 6 muaj, hiqne... Ky është sugjerimi im.

RRUSTEM BERISHA: Edhe ne për këto afatet nënligjore.

SABRI HAMITI: Po them jo një vit, por gjashtë muaj.

KRYETARI: Pajtohem! Unë mendoj se 6 muaj le të jetë një presion, edhe pse mund të bëjmë fakte, që është shumë me i bë komplet, por po pajtohem.

Atëherë, kush është për amendamentet në tërësi, le të çojë dorën? Faleminderit! Glauku nuk e çoi dorën, por me shumicë të votave e aprovojmë dhe i sugjerojmë Kuvendit të dërgohen në komisionet tjera. Dhe ne kthehem përsëri t'i bëjmë këto.

A do ndokush të shtojë diçka? Jo! Faleminderit!

Përgaditi:

Njësia për transkript